

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7727 E diel 2 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** **Ditës**
Mbledhja e dy qeverive në Pejë, asaj të Shqipërisë dhe Kosovës, nuk kishte asgjë të re për sa i takon aspektit ekonomik. Vazhdon e njëjta amulli në ekonomi ...
Vijon në faqen 21

Nga DRITAN HILA
Pse e trash Rama zërin në Kosovë


Dje **në "Deutsche Welle"**
Në vitin 1976 unë kam udhëtuar nëpër Jugosllavi duke u ngritur dorën makinave në rrugë, sigurisht për të parë bregdetin. Vite më vonë e kuptova se kisha ...
Vijon në faqen 21

Nga VOKLER WAGENER
Jugosllavia: E dashur, e urryer, e shpërbërë




Lista e përfituesve nga fondi i ALUIZNI-t

Emrat, pronarët që ndajnë 200 milionë lekë në 5 këste, në Tiranë e në rrethe

Ndërtimet informale, ish-pronarët do të marrin kompensim financiar në masën 70%

Agjencia e Trajtitimit të Pronave (ATP) njofton se ka përfunduar procesin e shqyrtimit për 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) kërkesa, të paraqitura nga subjektet përfitues, pronar të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimet informale, që përfitojnë deri më tani kompensim/ shpërblimin në vlerë ...

Në faqen 11

QEVERIA GJERMANE I PERGJIGJET TE DJATHTEVE: TIRANA KA ROL NE RAJON

MERKEL, JEP "LLOGARI" TE BUNDESTAGU PER SHQIPERINE

Populistët e "AfD" kërkojnë informacion, qeveria gjermane: Vjet hetuam 217 shqiptarë për krime. Asnjë parti s'mbështet bashkimin me Kosovën në një shtet



(Në foto) Kancelarja gjermane Angela Merkel gjatë vizitës në Tiranë

Në faqen 7

"MIKU I SHQIPTAREVE"

Ndërron jetë në moshën 94-vjeçare ish-presidenti i SHBA, Xhorxh Bush

Në faqen 7

ISH-KRYEPROKURORI

Dosja "Llalla", Krimet e Rënda kërkojnë të hetohet edhe në Gjermani

Në faqen 5

28 DITE PROTESTE

Banorët e Unazës së Re përplasen me policinë, deputeti i shoqëron në rajon

Në faqen 3

OPERACIONI NE ITALI

Kapet gomonia me 1.5 tonë kanabis, dyshohet se u nis nga Shqipëria

Në faqen 5

EKSKLUZIVE/ DOKUMENTET E VITEVE 1985 DHE 1995



Besnik Bakiu: Ja marrëveshjet tona me Greqinë për çështjet e kufirit

Në faqen 8-9

MIRAS Dokumenti i 27 marsit 1991 ku skicohet organizimi i mërgatës shqiptare

Letra e rrallë, rrëfimi i fundit i Martin Camajit

Në brendësi: Poezi nga Fasliti Haliti. Ben Andoni: Tirana-Mahnia e Rezarta Delisulës

NGA PROF. DR. BARDHYL DEMIRAJ

Ku dhemb dhëmbi, vete gjuha! Është një përvojë popullore kjo që e dëgjojmë, e lexojmë dhe e përjetojmë shpesh, sidomos kur jeshim në kapërcyell të moteve, bash kur e ndjejmë si nevojë të brendshme e të domosdoshme



me u rrëfyer për jetën e jetuar në vetvete sikurse, madje sidomos, detyrimet ndaj saj, duke ngërthyer kështu angazhimin e sekujt në ato rrethe intelektuale e shtresa sociale-kulturore ku bën pjesë. Parë nga kjo perspektivë marrëdhëniet e Martin Camajit me klierin ...

Suplement

ZGJEDHJET VENDORE

TIRANA

Dy eksponentët e lartë të LSI nuk janë dakord me deklaratën e kryetares

Deklarata "Veliaj ka punuar", Vasili dhe Manjani kundër Kryemadhit

"Kush mbështet modelin Veliaj i bën dëm kryeqytetit"

Deklaratat e kryetares së Lëvizjes Socialiste për Integrim se "Erion Veliaj ka punuar" dhe se ai është kandidatura më e mirë që mazhoranca ka për të kandiduar për Bashkinë e Tiranës, ka shkaktuar një sërë reagimesh pakënaqësie nga eksponentët tjerë kryesor të LSI-së. Kështu, ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani me anë të një reagoni në rrjetet sociale kundër shtoi deklaratën e Kryemadhit, duke theksuar se Veliaj nuk e meriton dot mbështetjen dhe votën e tij dhe pasi nuk i ka mbajtur premtimet që ka dhënë në 2015. "Shprehja që "Erioni ka punuar", ka dalë dhe është ngulur në kokë nga vetë Erioni dhe media që i shërben. Shifrat dhe logjika e thjeshtë na mësojnë se Erioni ka bërë shumë pak në raport me buxhetin e rritur nga rritja e taksave dhe tarifave. Luksin buxhetor që pati Erioni nuk e ka pasur as vetë Edi Rama. Luizim Basha jo e jo", shkroi Manjani. Më tej ai shprehet se kryebashkiaku aktual i Tiranës nuk punoi për të mbajtur premtimet me të cilat mori votën, ku Manjani evidenton atë për të mos lejuar ndërtime të tjera në Tiranë. "Erioni na mashtroi paq kur tha se nuk do lejonte kulla, por do bënte parqe. Madje do bënte rrugë që të lidheshin liqenet e Tiranës. Në fakt, firmosi leje kullash nga më të lartat e mundshme. Mashtrimi dhe mosmbajtja e fjalës së dhënë janë krye-arsyet për të braktisur një të zgjedhur", nënvizoi Manjani.



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

PREMTIMET

"Erioni na mashtroi paq kur tha se nuk do lejonte kulla, por do bënte parqe. Madje do bënte rrugë që të lidheshin liqenet e Tiranës. Në fakt, firmosi leje kullash nga më të lartat e mundshme. Mashtrimi dhe mosmbajtja e fjalës së dhënë janë krye-arsyet për të braktisur një të zgjedhur", nënvizoi Manjani.

Protesta e banorëve të Unaza e Madhe

CFARË THA KRYEMADHI PËR VELIAJN

Dy ditë më parë kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi do të lavdëronte punën që ka bërë Erion Veliaj në krye të bashkisë së Tiranës, pasi sipas nuk mund t'i mohojë puna e bërë. "Nuk mund të thuash se s'ka punuar Erion Veliaj, Rama nuk mund të ketë njeri që të punojë më shumë se Edi Rama. Veliaj me llumin me kriminelin e drogaxhinjtë nuk përfshihet ndërsa Rama është i kapur".

Ish-deputeti humbet në Shkodër me dy vota diferencë

Zgjedhjet, PD me kryetarë të rinj në Shkodër, Vlorë dhe Lezhë

Ish-deputeti dhe kryetari i deritanishëm i demokratëve në Shkodër, Ramiz Çobaj nuk ka mundur të zgjidhet sërish për një mandat tjetër në krye të PD-së së Shkodrës. Partia Demokratike ka vijuar edhe këtë të shtunë zgjedhjet për kryetar të degëve të saj, ku mes të cilave ishte edhe dega e Shkodrës. Në fakt, ndryshe nga shumë degë të tjera, zgjedhjet në Shkodër kanë qenë një surprizë, kjo për vet faktin se kryetari aktual i kësaj partie për Shkodrën nuk arriti të rikandidohet, teksa ka humbur me dy vota përballë rivalit të tij Xhevdet Amuli. Amuli mori 243 vota, ndërkohe që Çobaj mori 241 vota, ndërsa 8 vota janë shpallur të pavlefshme. Në Kuvendin e degës së PD në Shkodër kanë marrë pjesë rreth 500 delegatë me të drejtë vote. Ndërkohe që pas përfundimit të procesit janë dëgjuar thirrjet nga demokratët "poshtë spiunët", "poshtë komunistët", "komunistët nuk e kanë vendin në PD", duke i adresuar ish-kryetarit tashmë të degës së PD në kryeqendrën e veriut,



lur të pavlefshme. Në Kuvendin e degës së PD në Shkodër kanë marrë pjesë rreth 500 delegatë me të drejtë vote. Ndërkohe që pas përfundimit të procesit janë dëgjuar thirrjet nga demokratët "poshtë spiunët", "poshtë komunistët", "komunistët nuk e kanë vendin në PD", duke i adresuar ish-kryetarit tashmë të degës së PD në kryeqendrën e veriut,

Ramiz Çobaj. PD ka mundur të zgjedhë edhe kryetarin e një tjetër degë të rëndësishme. Bëhet fjalë për PD-në e Vlorës, ku kryetar i ri u zgjodh Genc Deromemaj, i cili fitoi me 12 vota diferencë përballë Gjergj Nikës. Kujtojmë se Genc Deromemaj ka qenë edhe kandidat për kryetar i Bashkisë së Vlorës i kandiduar nga Partia Demokratike. Deromemaj mori 180 vota ndërsa Nika 168 vota. Gjatë ditës së djeshme PD mbyllti procesin e zgjedhjeve edhe në Lezhë, ku Zef Gjoka është zgjedhur kryetar i ri degës së PD-së. Përballë tij konkurreoi Paulin Marku, i cili mori vetëm 88 vota kundër kundërshtarit të tij, Zef Gjoka, i cili fitoi bindshëm me 306 vota.

dhe pastaj prap kthehet të gjenjeshtri dhe e mohon. I vërtetë ai është vetëm kur shan e shfryn dhe i quan qytetarët shpellarë, por pastaj prap kthehet të gjenjeshtri dhe e mohon që i ka quajtur ashtu", shkroi Vasili.

zonën urbane të Tiranës. Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, teksa e cilëson kryebashkiakun "gjenjeshhtar pa rivalë dhe konkurrencë", shprehet se Tirana, jo vetëm po shqepet me gjenjeshtra, por edhe po plaçket nga ai. "Tirana ka parë këto tre vjet një cumam të paparë gjenjeshtrash. Veliaj nuk ka rivalë si gjenjeshtri më i madh që ka qeverisur Tiranën dhe kjo është meritë e vetme e tij. I vërtetë ai është kur je leje për kulla pa fund në zemër të Tiranës

SHKURT

Grida Duma: Për mandatet e deputetëve do vendosin forumet

Deputetja demokratke Grida Duma deklaroi dje në studion e emisionit "Kjo Javë" në News24 se fati i mandatëve të deputetëve demokrat do përcaktohet nga një vendim i forumeve të Partisë Demokratike. Nisur nga bojkoti i parlamentit nga opozita që prej shtatorit, Duma tha se PD nuk do të mbërrijë deri në këtë moment, pasi më parë do ketë një vendimmarrje të forumeve të opozitës dhe Partisë Demokratike. "Nuk e di si procedurë. Nuk besojmë se do arrijmë deri atëherë. Nuk e di kur do të fillojë numërimi. Ne s'kemi qenë që në shtator. Mund ta fillojmë nga fillimi i sesionit të ri apo dhe nga korriku", tha ajo. Duma tha se paraqitja në Kuvend një herë në 6 muaj vetëm për të mos dëgjur mandatet e deputetëve është trashëgimi socialist dhe kjo nuk ka lidhje me demokratët. "Nuk ka lidhje me parashikimin, ka të bëjë me vendimin që i mbetet forumeve të partisë. Është vendim shumice. Është aksion politik jo karrierash dhe ambicjesh. Do ta kthenë në parlament reagim i maxhorancës. Duhet të ulen dhe të diskutohet në mënyrë konstruktive", deklaroi deputetja e PD.

Kryemadhi: 9000 maturantë elitare kanë kërkuar të ikin nga Shqipëria

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, mori pjesë dje në një takim me strukturat e LRI, ku u shpreh se mijëra të rinj po largohen çdo ditë nga vendi për shkak të keqeverisjes. Ajo u shpreh se Shqipëria ndodhet në një situatë emergjente, e për këtë bëri fajtor kryeministrin Edi Rama. "Mbi 9000 maturantë elitare kanë kërkuar të ikin nga Shqipëria. Kjo është një fatkeqësi që na ka rënë, ka rënë një sëmundje e madhe dhe e rrezikshme, mungesa e besimit, mungesa e shpresës. Kemi shumë të rinj e të reja që duan të ikin pa e kthyer kokën pas, ne nuk do të kemi më mjekë, juristë, mësues", tha Kryemadhi. Kryetarja e LSI, gjithashtu, preku gëshjen e Unazës së Re, për të cilën tha se arroganca e Ramës po bën një vjedhje të jashtëzakonshme duke i shembur shtëpitë e ndërtuar me djersë nga shqiptarë. "Ne nuk kemi kundër rrugës e kundër zhvillimit, por ama jemi kundër arrogancës së shtetit që shkel me këmbë qytetarët. Jemi kundër vjedhjes që bëhet prej 48 milionë eurosh, se keni harruar dhe TVSH-në. Vjedhje e jashtëzakonshme me litarin në fyt ndaj qytetarëve. Vidhen dhe pronat, e djersës dhe mundit të banorëve", shtoi Kryemadhi.



Forcat e Rendit shoqëruan me forcë në komisariat 5 protestues që u liruan më pas

Dita e 28 e protestës, banorët e Astirit konfrontohen me policinë

Deputeti Balliu shoqëron protestuesin në furgon

Ndonëse i gjithë segmenti i Unazës së Madhe nga Pallati me Shigjeta deri te Dogana është zhveshur thujtë nga të gjitha pemët, shtyllat elektrike dhe trafikndarësja dhe duke u bërë gati për nisjen e punimeve, banorët e zonës së Astirit janë të vendosur që të mos dorëzohen dhe të mos lejojnë prishjen e ndërtimeve të tyre. Ashtu siç kanë bërë thujtë për gati një muaj resht, edhe dje në mbremje ata kanë dalë sërish në rrugë, duke protestuar kundër qeverisë dhe bashkisë dhe duke kërkuar shpronësim të plotë për banesat e tyre që preken nga projekti i zgjerimit të unazës. Me thirrjet "Duam shtëpitë tona", "Kauza jonë, shtëpitë tona", "Qeveri hajdute", "O Edvin, o diarre këtu i thonë Unazë e Re", dhjetëra banorë të zonës së Astirit kanë bllokuar edhe mbrëmë qarkullimin e mjeteve në Unazën e Madhe, ndërsa janë mbështetur sërish nga deputetët e opozitës. Protestuesit janë shprehur se do mbrojnë shtëpitë e tyre pasi i kanë të ndërtuar me djersë dhe gjak. Ata, gjithashtu, kanë bërë të ditur se nuk do tërhiqen dhe do vazhdojnë protestat e tyre. "Ne do mbrojmë shtëpitë tona. Me këtë shtet ne jemi të zhgënjyer", tha një prej banorëve në protestë. Protesta është shoqëruar edhe me një prani të shtuar të forcave të policisë, çka duket se ka provokuar edhe protestuesit që kishin bllokuar rrugën. Për këtë shkak në protestën e mbrëmshme nuk kanë mundur as tensionet dhe përplasjet fizike me forcat e policisë. Për rrjedhojë të paktën 5 persona pjesëmarrës në protestë u shoqëruan nga Policia e Shtetit, ndërsa banorët pretenduan se mes të shoqëruarve është edhe një i mitur, por policia e hodhi poshtë pretendimin. Ndërkohë deputeti i PD, Klevis Balliu shoqëroi vetë në polici një prej protestuesve, duke mos lejuar që forcat e rendit të ushtronin dhunë ndaj të shoqëruarve. Deputeti Balliu tha se e shoqëroi të ndaluarin në furgonin e policisë, sepse policia ishte e dhunshme dhe prania e tij do të ndalonte abuzimin fizik. Mësohet se në Komisaratin e Policisë nr.6 u shoqëruan shtetasit Gentian Gjoni, Altin Çejku, ndërsa në Komisaratin e Policisë nr.3, Shkëlzen Sadikaj, Dritan Çejku dhe Adriatik Çejku.



TË SHOQËRUARIT NË KOMISARIAT
Mësohet se në Komisaratin e Policisë nr.6 u shoqëruan shtetasit Gentian Gjoni, Altin Çejku, ndërsa në Komisaratin e Policisë nr.3, Shkëlzen Sadikaj, Dritan Çejku dhe Adriatik Çejku. Ndërkohë që nga selia blu u shpërnda një video ku pretendonte se forcat e rendit kishin ushtruar dhunë ndaj protestuesve që kishin bllokuar rrugën.

Balliu: Arrestimet janë politike dhe për presion

U shoqëruan tri ditë më parë, lirohen dy banorë të Unazës

Dy prej banorëve që u arrestuan pak ditë më parë nga policia me akuzën për shkatërrim prone dhe akte vandalizmi kanë lënë dje qelitë. Bëhet fjalë për Kujtim Yllin dhe Romeo Llullën. Gjykata e ka shpallur të paligjshëm arrestimin e Yllit, ndërsa ka lënë në arrest shtëpi Llullën. Pas vendimit deputeti i PD-së Klevis Balliu që ndoqi procesin nga afër e quajti akt të turpshëm të qeverisë që sipas tij kërkoi t'iu bëjë presion banorëve nëpërmjet arrestimeve të paligjshme. "Arrestimet dhe shoqërimet janë politike. Vendimet që u morën, ishin shpallja ose arrestim i paligjshëm për Kujtim Yllin, sepse dukshëm arrestimi ishte thjesht politik për të ushtruar presion ndaj banorëve, të cilët bëjnë sot 28 ditë që po protestojnë. Është një akt i turpshëm i kësaj qeverie që kërkoi t'iu bëjë presion këtyre banorëve me anë të shoqëri-



meve dhe arrestimeve të paligjshme, siç e vendosi dhe gjykata për rastin e zotit Ylli, deklaroi Balliu. Ai i bëri thirrje kryeministrit Edi Rama dhe kryetarit të Bashkisë Erion Veliaj të tërhiqen nga këto akte, që i quajti barbare dhe sulm ndaj sistemit demokratik. Balliu tha se PD do vazhdojë të mbështesë protestën e banorëve. "Dua t'i bëj thirrje qeverisë së Ramës, Erion Veliajt të tërhiqen nga këto

akte barbare që janë një sulm jo vetëm ndaj protestës por ndaj vetë sistemit demokratik që është vendosur në Shqipëri që e kanë vendosur këta qytetarë me protesta dhe luftën ndaj regjimit komunist. PD do t'i mbështesë qytetarët e Unazës së Re si dhe çdo qytetar që lufton për një kauzë të drejtë për një kauzë ligjore si në rastin e kauzës së banorëve të Unazës së Re", tha Balliu.

Sadikaj, Dritan Çejku dhe Adriatik Çejku. Ndërkohë që nga selia blu u shpërnda një video ku pretendonte se forcat e rendit kishin ushtruar dhunë ndaj protestuesve që kishin bllokuar rrugën. Më pas protesta u zhvendos para komisarariatit nr.6, ku banorët u mblodhën për të

kërkuar lirimin e të shoqëruarve. Si pasojë edhe mbështetjes së tyre në orë e vona të mbremjes të 5 të shoqëruarit e policisë u liruan sërish. Banorët e kësaj zonë vijojnë protestën e tyre, prej 28 ditësh, me anë të së cilës kërkojnë dëmshpërblim 100% në vlerën e tregut për

objektet që preken nga projekti i "Unazës së Madhe". Protestës së tyre, prej ditësh u janë bashkuar edhe deputetët e opozitës, të cilët mbështesin kërkesat e protestuesve si të drejta, ndërsa kanë akuzuar qeverinë për shurdhëri dhe projekt korruptiv.



Brahimllari: Arrestimet e protestuesve janë të paligjshme

Deputeti i LSI-së, En drit Brahimllari, ndërsa ishte i pranishëm mbremjen e djeshme protestën e Unazës së Re, e cilësoi si terror të Ramës arrestimin e protestuesve, ndërsa u shpreh i bindur se qëndresa e tyre do të vazhdojë. Për deputetin e Lëvizjes Socialiste për Integritim, çdo arrestim në këtë protestë është i paligjshëm, sepse sipas tij banorët po mbrojnë të drejtën legjitime të pronës. "Është terrori i Edi Ramës mbi këto banorë. Edi Rama po ushtron presione nga më të ndryshmet për të shtypur protestën e banorëve të Unazës së Re, por banorët janë të vendosur për t'i shkuar dert në fund. Janë të vendosur për ta çuar deri në fund, sepse i cenohet prona e tyre, të cilën e kanë ndërtuar me gjak në këto 28 vite. Të jemi të bindur që ashtu sikundër ndryshoi vendimin për arrestimin për z. Ylli, ashtu edhe të gjithë arrestimet e tjera janë të paligjshme, sepse nuk mund të arrestosh një protestues, i cili proteston për të drejtën e tij", tha Brahimllari.



Unaza e Madhe, Veliaj: Historia s'ka një rresht për vandalët

Përmes një postimi në rrjetet sociale kryebashkiaku Erion Veliaj ka falënderuar të gjithë ata banorë të zonës së "Astirit" që preken nga projekti i zhvillimit të "Unazës së Madhe" dhe që iu përgjigjën thirrjes së tij për të bashkëpunuar. Veliaj thekson se kur të shkruhet historia e Tiranës, askush nuk do kujtojë penguesit, por do kujtojë të gjithë ata njerëz të mirë që çuan qytetin përpara e i hapën rrugë zhvillimit. "Kur të shkruhet historia e Tiranës, askush nuk do kujtojë penguesit e vandalët, historia s'ka 1 rresht për këta tipa! Ama do kujtojë ata njerëz të mirë që çuan qytetin përpara e i hapën rrugë zhvillimit. Mirënjohje gjithë familjeve që çdo ditë e më shumë po lejojnë Unazën e Re", thekson Veliaj. Sipas Bashkisë, familjet që preken nga projekti i zgjerimit të Unazës së Madhe dhe që nuk disponojnë dokumente, po zhvendosen në banesa sociale ku mund të banojnë në to pa afat.

RAPORTI
MEDIA

"Dy javë përpara sulmit, ajo lidhi deputetin e Partisë Socialiste me Shullazin"

"Reporterët pa kufij": Sulmi ndaj Klodiana Lalës lidhet me punën e saj

Pjesë e raportit janë edhe gazetarët Çollaku dhe Tota

Organizata ndërko mbëtare "Reporterët pa kufij" ka publikuar raportin e saj mbi gjendjen e medias në mbarë botën për vitin 2018, duke evidentuar rastet më të rënda ku gazetarët ose kanë humbur jetën ose janë sulmuar nga krimi dhe politika. Krahas ngjarjeve më të rënda të shoqëruara me humbje jete të gazetarëve në vende të ndryshme të botës, raporti trajton edhe tre rastet e gazetarëve shqiptarë, gazetares së News24, Klodiana Lala dhe të Basir Çollakut dhe Alida Totës. Raporti thekson se jeta e të tre gazetarëve shqiptar është kërcënuar për shkak të punës së tyre si gazetarë dhe të raportimeve që ata i kanë bërë lidhjeve të krimit me politikën në vend. Duke evidentuar rastin e gazetares Klodiana Lala, raporti thekson se shtëpia e familjes së saj u bë objekt i një sulmi me armë si pasojë e drejtpërdrejtë e veprimtarisë së saj si gazetare investigative. Për ngjarjen e ndodhur më 30 gusht të 2018-ës, kjo organizatë thotë se ndodhi vetëm dy javë pasi gazetarja Lala kishte lidhur deputetin e Partisë Socialiste, Jurgis Çyrbja, me bandën e Emiljano Shullazit. "Shtëpia e familjes së reporterit shqiptar të krimit, Klodiana Lala, u shënjestrua në orët e para të 30 gushtit 2018. Lala, që mbulon krimin e organizuar për televizionin News 24, për më shumë se 10 vite, shkruajti në 'Facebook' se sulmi lidhej direkt me raportimin e saj investigativ. Dy javë përpara sulmit, ajo lidhi deputetin e Partisë Socialiste me organizatën e kryesuar nga Emiljano Shullazi, që dyshohet se është një nga bosët kryesorë të krimit në vend", thuhet në raport lidhur me këtë rast. Gjithashtu, raporti evidenton edhe se "gazetari i pavarur shqiptar Basir Çollaku është në prag të zgjedhjes së mërgimit, si Roberto Saviano, i cili tani shpenzon në shumë kohë në Shtetet e Bashkuara sesa në Itali". Sipas raportit Çollaku "bezdisi" ministritin e Brendshëm të Shqipërisë duke marrë një intervistë ekskluzive me Dritan Zaganin, i cili dënonte lidhje e policisë me grupet e trafikimit të drogës në



Gazetarja Klodiana Lala

BASIR ÇOLLAKU

"Jeta e Çollakut është kthyer në makth, duke kufizuar lëvizjet gjatë natës pasi frikësohet se mund të bëhet shënjestër e banditëve të paguar nga trafikantët e drogës. Kjo situatë ka prekur familjen dhe punën e tij. Tani ai po mendon seriozisht të braktisë Shqipërinë", - shkruhet në raport.

Raporti: Grupet kriminale shqiptare të ngjashme me mafien italiane

Raporti i "Reporterët pa kufij" i rendit grupet kriminale shqiptare në një rang me grupet më të famshme mafioze në botë. Sipas këtij raporti grupet e krahasueshme me mafien italiane, kineze apo japoneze "gjenden në Rusi dhe në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik, në Turqi dhe në Shqipëri". Raporti i vitit 2018 flet për krimin e organizuar që ka shtuar kërcënimet ndaj gazetarëve dhe mediave. Gjithashtu, problem konsiderohen edhe ndërhyrjet politike. Sipas raportit, mbi 30 gazetarë në të gjithë botën janë vrarë nga organizata kriminale që prej nisjes së vitit 2017. Reporterët pa kufij kanë disa muaj që kryejnë kërkime për realizimin e këtij raporti, përfshirë edhe intervista me gazetarë të piketuar, kolegët dhe familjarët e




tyre. "Krimi i organizuar nuk njih kufij" - thotë raporti. Të paktën 10 gazetarë janë vrarë këtë vit në Brazil, Kolumbia dhe Meksikë. Kjo shifër mund të jetë shumë më e lartë, sepse kriminelët dhe politikanët shpesh bëhen aleatë kundër gazetarëve dhe pandëshkueshmëria mbre-

vlorë. "Jeta e Çollakut është kthyer në makth, duke kufizuar lëvizjet gjatë natës pasi frikësohet se mund të bëhet shënjestër e banditëve të paguar nga trafikantët e drogës. Kjo situatë ka prekur familjen dhe punën e tij. Tani ai po mendon seriozisht të braktisë Shqipërinë", - shkruhet në raport. "Reporterët pa kufij" shkruan se disa prej dekla-

rive të Zaganit janë konfirmuar nga hetimet në Itali, ndërsa evidenton se "disa media të qeverisë" u përpogën të prishin imazhin e kolegët të tyre. Pjesë e këtij raporti është bërë edhe gazetarja Alida Tota. "Historia që saboto karrierën e saj ishte vdekja e punëtorit 17-vjeçar në depozitimin e tmerrshëm të mbetjeve, ku ajo përmendi kushtet e vështira dhe të rrez-

ikshme në vendet të ndryshme në botë. Në Indi, Kamboxhia dhe disa vende afrikane, grupet kriminale pasurohen duke thyer të gjitha rregullat e mjedisit duke vjedhur burimet natyrore. Gazetarët që kanë hedhur dritë mbi trafikimin e mineraleve, drurit dhe naftës janë të ekspozuar ndaj një rreziku të madh. Edhe Europa nuk i ka shpëtuar një rreziku të tillë. Të paktën dy gazetarë janë vrarë në lidhje me punën e tyre gjatë dy viteve të fundit: Daphne Galizia i vu bombë poshtë makinës në Maltë në tetor të 2017, ndërsa Ján Kuciak e qëlluan për vdekje së bashku me të fejuarën në shkurt të 2018. Në Itali, 10 gazetarë janë nën mbrojtjen e plotë të policisë ditë e natë, ndërkohë që ka edhe shumë të tjerë", - thuhet në raport.

ikshme, mungesën e kontrave të punës dhe përfshirjen e Bashkisë së Tiranës. Ajo u shkarkua ditën pas kërkoi nga bashkia e qytetit që të jepte versionin e saj. Asaj, gjithashtu, iu kërkua të braktiste historinë", shkruhet në raport. Më tej lidhur "Reporterët pa kufij" thotë në raport se Tota ishte shënjestër edhe e një sulmi me bombë pasi kishte emigruar në Suedi.



Shkarkimi

ALIDA TOTA

"Ajo u shkarkua ditën pas kërkoi nga bashkia e qytetit që të jepte versionin e saj. Asaj, gjithashtu, iu kërkua të braktiste historinë", - shkruhet në raport. Më tej "Reporterët pa kufij" thotë në raport se Tota ishte shënjestër edhe e një sulmi me bombë pasi kishte emigruar në Suedi.

Vokshi: Raporti është tronditës, rrezon propagandën e Ramës

Kryetarja e Komisionit të Medias dhe Komunikimit, Albana Vokshi duke cituar raportin e "Reporterëve pa kufij" e ka cilësuar tronditës faktin që Shqipëria është në mesin e 5 vendeve në botë me krim të organizuar më të rrezikshëm. "Që në faqen e parë të raportit, Shqipëria përshkruhet si vendi ku krimi i organizuar ka fuqinë e organizatave më të tmerrshme kriminale, mafies italiane, triadës kineze, jakuzit japonez, mafies ruse dhe asaj turke. Nën qeverisjen e Edi Ramës, Shqipëria ka krijuar imazhin e një vendi parajsë për trafikun e drogës, por kjo është hera e parë që Shqipëria renditet në raportin e Reporterëve pa kufij si një nga 5 vendet në botë me krim të organizuar shumë të rrezikshëm. Siç pohon raporti, i titulluar, "Gazetarët- beteja e zezë e krimit të organizuar", kjo situatë alarmante ka ndikuar drejtpërsëdrejti në lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve, përfshirë edhe Shqipërinë", tha Vokshi. Duke iu referuar pikërisht rasteve të tre gazetarëve shqiptarë që trajton ky raport, Vokshi theksoi se gazetarët në Shqipëri janë të kërcënuar për shkak të punës që bëjnë. "Historitë e tre gazetarëve shqiptarë: Klodiana Lala, Basir Çollaku dhe Alida Tota janë tri rastet e përfshira në raportin e "Reporterëve pa kufij". Të tria historitë kanë një të përbashkët: Gazetarët janë kërcënuar për shkak të denoncimeve që ata u kanë bërë lidhjeve të ngushta me krimin të organizuar me pushtetin, Jurgis Çyrbjen me Emiljano Shullazin, Saimir Tahirin me drogën e Habilajve, Erion Veliajn me mafian e plehrave"-tha Vokshi.

Shitje me Ankand të trete nga Studio Permbarrimore L.D.C

1. "Ndertese", me sipërfaqe 600 m2, me Nr. Pasurie 495/15, Volum 5, faqe 83, ndodhur në Zonen kadastrale 3426 me adresë në Tulline, Tiranë. Regjistruar në Zyren Vendore Regjistrimit Pasurive Pualujshme Tiranë Çmimi fillestar për shitje është 2.116.800 leke.

Data e shpalljes 30.10.2018
Data e zhvillimit 03.11.2018 deri në orën 16:00

Ankand zhvillohet në ambientet e Studios Permbarrimore L.D.C me adresë Rruga "Myslim Shyri" Vll 8/1, kati 1 Tiranë.

"Këtë vit është ulur me 50% numri i vrasjeve në krahasim me vitin 2017"

VLORE

Dy ditë pas transmetimit të një emisioni ekskluziv nga Top Channel, (shoqëruar dhe me dëshmitë e familjarëve) ku flitej për zhdukjen e 80 personave në Vlorë gjatë tre viteve të fundit, numër ky i cituar edhe nga deputeti i PD-së, Ervin Saliñji ka ardhur reagimi zyrtar i prokurorisë dhe policisë së qytetit bregdetar. Përmes një deklarate të përbashkët për mediat, dy institucionet ligjzbatuese sqaruan se numri total i personave të larguar nga banesa është 23. "Shumë prej këtyre personave janë larguar me dëshirë nga banesa, por dhe janë rikthyer", bëri me dije policia. Ndërkaq, blutë pohuan se "megjithëse të gjitha rastet janë referuar në prokurori, vetëm për 4 raste në 3 vitet e fundit janë konstatuar elementë të veprës penale dhe janë regjistruar në prokurori si çështje, e ndërkohë po vijojnë hetimet për gjetjen e tyre".

DEKLARATA E POLICISË DHE PROKURORISË

Nisur nga transmetimi në TV Top Channel i një reportazhi, ku flitet për rreth 80 persona të zhdukur në vitet e fundit, një numër i cituar edhe nga foltorja e PD-së ditën e djeshme (të premtën), prokuroria dhe policia e Vlorës sqarojnë opinionin publik se: Në 3 vitet e fundit rezultojnë se numri total i personave të larguar nga banesa është 23. Sipas këtyre dy institucioneve, në vitin 2016 rezultojnë

"Në 3 vitet e fundit, në Vlorë janë zhdukur në total 23 persona"

Reagon policia dhe prokuroria: Gjatë 2018-ës janë larguar nga banesa 13 shtetas, disa janë rikthyer



4 shtetas të larguar; në 2017 rezultojnë, 6 shtetas të larguar dhe këtë vit rezultojnë 13 shtetas të larguar. Ndërkaq, në njoftimin zyrtar thuhet se shumë prej këtyre personave janë larguar

me dëshirë nga banesa, por dhe janë rikthyer. Megjithëse të gjitha rastet janë referuar në prokurori, vetëm për 4 raste në 3 vitet e fundit janë konstatuar elementë të veprës penale

dhe janë regjistruar në prokurori si çështje, e ndërkohë po vijojnë hetimet për gjetjen e tyre. Gjithashtu, për sa i përket veprave penale kundër personit, bëjmë me dije se në krahasim me 1 vit më parë ka ulje të ndjeshme, konkretisht: Nga 12 vrasje të evidentuara në vitin 2017, numri i tyre ka rënë me 50%, ose në 6 vrasje në 2018. Nga 10 vrasje të mbetura në tentativë në 2017, është ulur me 50% numri në 2018, pra janë 5 tentativa të evidentuara. Të gjitha strukturat e policisë, në bashkëpunim me prokurorinë e agjenci të tjera ligjzbatuese, vijojnë punën intensive për goditjen e paligjshmërisë me qëllim ruajtjen e paramestrave të rendit dhe të sigurisë e në shërbim të qytetarëve". shkruhet në njoftimin e policisë.

80

RASTE

Ndryshe nga shifrat zyrtare të dhëna nga policia dhe prokuroria e Vlorës, prokurorja Flora Çela është shprehur për emisionin Top Story se numri i personave të raportuar, të zhdukur, të humbur, nga familjarët nga viti 2015 deri tani, ka pasur një numër rreth 80 referimesh. Nga denoncimet e familjarëve organet ligjzbatuese kanë evidentuar vetëm katër raste për ekzistencën e veprave penale, atë të trafikimit të lëndëve narkotike dhe të rrëmbimit të personit.



Saliñji:
80 të zhdukur në Vlorë, vendi në emergjencë kombëtare

TIRANË - Deputeti i Partisë Demokratike, Ervin Saliñji ka reaguar pas shifrave të personave të zhdukur në Vlorë, të publikuara së fundi. Saliñji tha se 80 persona janë denoncuar të zhdukur e të rrëmbyer në 3 vjet në zonën elektorale të kryeministrit. Ai theksoi se me këto të dhëna provohet zyrtarisht denoncimi i PD për të zhdukurit e bandave të drogës në Vlorë. Deputeti i PD-së u shpreh se dëshmitë e familjarëve faktojnë përfshirjen e policisë jo vetëm në lehtësimin e trafikut, por dhe në dekonspirimin dhe kërcënimin e familjarëve të të zhdukurve.

Ai theksoi se me këto të dhëna provohet zyrtarisht denoncimi i PD-së për të zhdukurit e bandave të drogës në Vlorë. Sipas tij, vendi është në emergjencë kombëtare, prandaj është jetik ndarja e politikës nga krimi nëpërmjet vetingut të politikanëve, duke nisur që nga kreu i qeverisë.

DURRËS - Policia e Durrësit në bashkëpunim me atë të Shijakut kanë vënë në prangë një 20-vjeçar nga Shkodra, i akuzuar për 12 vjedhje banesash me thyerje. Në kërkim është shpallur bashkëpunëtori i tij, edhe ai nga Shkodra. Burime nga policia lokale bënë me dije se ata janë autorë të 12 vjedhjeve të ndodhura nga 2 tetori deri me 30 nëntor të këtij viti. Po kështu kanë kanosur me armë një shtetas të mitur.

Sipas burimeve të mësipërme, mbërmjen e së premtës është finalizuar operacioni i koduar "Alfa", ku është arrestuar në flagrancë shtetasi: Frederik Shkambi 20 vjeç, banues në Shkodër; i dënau më parë për veprat penale: "Vjedhja e kryer në bashkëpunim" dhe "Mosbindje ndaj urdhrorit të punonjësit të rendit publik". Shtetasi i mësipërm ishte edhe person i shpallur në kërkim, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprën penale "Vjedhje me dhunë e kryer në bashkëpunim". Gjithashtu, është shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e shtetasit Z.N. 26 vjeç, banues në Shkodër. Nga kryerja e veprimeve hetimore dhe procedurale është dokumentuar me prova shkencore se shtetasi të mësipërm në bashkëpunim me

Policia: Dy të rinjtë kanë kanosur me armë një të mitur

Bastisën 12 banesa në 2 muaj në Shijak, kapet 20-vjeçari nga Shkodra, në kërkim bashkëpunëtori



njëri-tjetrit dyshohen si autorë të 12 vjedhjeve banesash me thyerje në territorin e Komisarariatit të Policisë Shijak, konkretisht:

Më datë 02.10.2018 dyshohet se kanë tentuar të vjedhin me thyerje banesën e shtetasit S.M.

Më datë 02.10.2018 dyshohet se kanë tentuar të vjedhin me thyerje banesën e shtetasit H.B.

Më datë 11.10.2018 dyshohet se kanë vjedhur banesën e shtetasit K.D. ku kanë marrë vlera monetare dhe bizhuteri.

Më datë 10.11.2018 dyshohet se kanë vjedhur me thyerje banesën e shtetasit M.M. ku kanë marrë vlera monetare dhe bizhuteri.

Më datë 14.11.2018 dyshohet se kanë vjedhur banesën e shtetasit Xh.T. ku kanë marrë vlera monetare.

Më datë 17.11.2018 dyshohet se kanë vjedhur banesën e shtetasit P.L. ku kanë marrë vlera monetare.

Më datë 30.11.2018 dyshohet se kanë vjedhur me thyerje banesën e shtetasit B.LL. ku kanë marrë vlera monetare dhe bizhuteri.

Më datë 30.11.2018 dyshohet se kanë vjedhur me thyerje banesën e shtetasit M.S. ku kanë marrë vlera monetare dhe orëndi shtëpiake.

Më datë 30.11.2018 dyshohet se kanë vjedhur me thyerje banesën e shtetasit Sh.D. ku kanë marrë vlera monetare dhe Laptop.

Më datë 30.11.2018 dyshohet se kanë vjedhur me thyerje banesën e shtetasit Z.D. ku kanë marrë vlera monetare.

Më datë 30.11.2018 dyshohet se kanë vjedhur me thyerje banesën e shtetasit M.J. ku kanë marrë orëndi shtëpiake.

Më datë 30.11.2018 dyshohet se kanë vjedhur me thyerje banesën e shtetasit Sh.T. ku kanë marrë vlera monetare dhe bizhuteri.

erje banesën e shtetasit Sh.T. ku kanë marrë vlera monetare dhe bizhuteri.

Gjithashtu, po më datë 30.11.2018 kanë kanosur me armë pranë banesës një shtetas të mitur Xh.Sh. 17 vjeç.

Shtetasi të mësipërm nuk i janë bindur urdhrorit të punonjësit të policisë për të ndaluar mjjetin. Ndërkaq, janë sekuestruar në cilësinë e provave materiale: një automjet tip Alfa Romeo; vlera monetare në euro dhe lekë; mjjetet që përdorin për hapjen e bravave të banesave dhe thyerjen e tyre si: dorëza, kaçavida, pinca.


Nga ana e efektiveve të Komisarariatit të Policisë Shijak në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës vijon puna për dokumentimin e veprimtarisë kriminale të këtyre shtetasve pasi dyshohet se janë autorë edhe të disa ngjarjeve të tjera "Vjedhje me dhunë" të kryera në rrethe të tjera. Materialet në ngarkim të dy të rinjve i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme.



Goditet një tjetër grup hajdutësh në Durrës, arrestohen 2 të rinj

DURRËS - Dy të rinj kanë rënë në prangat e policisë, si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal, përgjegjës për 3 vjedhje në qytetin e Durrësit. Bëhet fjalë për 30-vjeçarin Xhani Ymeri dhe 27-vjeçarin Ekilian Bili, të dy banues në këtë qytet. Sipas bluve, këta persona dyshohen si përgjegjës për vjedhjen e 200 mijë lekë të vjetra në lagjen nr.8 të Durrësit ku paguheshin gjoja. "Shtetasit e mësipërm ditën e sotme, në lagjen nr.8 dyshohet se kanë vjedhur zyrën ku paguheshin gjoja ku kanë marrë 200 000 lekë (të vjetra). Më datë 27.11.2018 dyshohet se kanë vjedhur me thyerje dhomën e Imazherisë në Spitalin Pediatric Durrës. Më datë 30.11.2018, në lagjen Nr.8 dyshohet se kanë vjedhur banesën e shtetasit A.Ç. ku kanë marrë dritare dhe dyer duralumin dhe i kanë shitur në një pikë grumbullimi hekurash. U sekuestruan në cilësinë e provave materiale; një pjesë e pajisjeve të vjedhura në zyrën e Imazherisë; dyert dhe dritaret duralumin të vjedhura në banesën e shtetasit A.Ç; dorëza, pinca dhe kaçavida. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme për veprën penale "Vjedhja në bashkëpunim" parashikuar në nenin 134/2 të Kodit Penal", njofton policia.

SHBA



Ish-presidentit George H.W. Bush

Ndërron jetë në moshën 94-vjeçare ish-presidenti amerikan, Xhorxh Bush

Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës ngushëlluan të shtunën popullin amerikan për vdekjen e ish-presidentit George H.W. Bush.

Në shkrimet e tyre ata vunë theksin tek "paralajmërimi i Krishtlindjeve", një letër e dhjetorit të vitit 1992 që George H. W. Bush i kishit drejtuar atëbotë presidentit të Serbisë, Sllobodan Millosheviç, në të cilën thuhet se në rast të një konflikti në

Kosovë të shkaktuar nga veprimi serb, Shtetet e Bashkuara do të jenë gati të përdorin forcën ushtarake.

Duke shprehur ngushëllimet e tij, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, shkroi në rrjetet sociale se "Shtetet e Bashkuara dhe bota do ta kujtojnë si patriot të pashoq dhe shembull të përkushtimit për të punuar për fuqizimin e demokracisë botërore dhe përhapjen e vlerave të lirisë. Kosova dhe shqiptarët

do ta kujtojnë si president të parë, që qysh në fillim të viteve '90 ia bëri shumë qartë regjimit të Millosheviçit, me Vërejtjen e Kërshëndellave, se Kosova është vijë e kuqe për SHBA. Bashkëndejmë me familjen Bush dhe tërë popullin amerikan në këtë humbje të madhe", shkroi ai.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj shkroi se "Kosova humbi një mik të madh e Shtetet e Bashkuara, patriot të devotshëm". Duke

shprehur pikëllimin e tij ai shkroi se George H.W. Bush gjithë jetën e tij e dedikoi në shërbim të popullit amerikan dhe paqes në botë. "Presidenti Bush do të mbahet në mend për denoncimin direkt ndaj represionit dhe terrorit serb në Kosovë. Ai do të mbahet në mend për "mesazhin e Krishtlindjeve" drejtuar presidentit serb në vitin 1992, me të cilin vendos vijën e kuqe për luftë në Kosovë duke e mbrojtur popullin tonë nga tendenca dhe kërcënimi për shfarosje nga regjimi i Millosheviçit në atë kohë", shkroi kryeministri Haradinaj.

Përgjigje ndaj pyetje të të djathtëve të "AFD": Nuk ka parti që mbështesin bashkimin me Kosovën

Merkel: Shqipëria, rol pozitiv në Ballkan

Qeveria gjermane: 214 shqiptarë u hetuan për krime të ndryshme gjatë 2017

Qeveria gjermane është e mendimit se Shqipëria luan parimisht një rol pozitiv në rajon. Dhe se në Shqipëri nuk ka aktivitete ose parti që e mbështesin idenë e bashkimit me Kosovën. Këtë ajo e vë në dukje në një përgjigje ndaj një kërkese të vogël të deputetëve Markus Frohnmair, Dietmar Friedhoff dhe grupit parlamentar "Alternativë për Germaninë" (AFD), që e ka redaksia e Deutsche Welle-s. "Në Shqipëri ekziston konsensus mbipartiak për anëtarësinë në NATO, integrimin në BE, për një shtet demokratik dhe kushtetues dhe për mirëkuptim në politikat rajonale", thuhet ndër të tjera në dokument.

Partia djathtë e ka shtruar pyetjen duke u nisur nga vizita e ministrit Heiko Maas në Tiranë, në shtator të këtij viti, dhe deklaratat e tij atje, ku e kishte vlerësuar ndër të tjera Shqipërinë edhe si garante të paqes në rajon.

PËRGJEGJËSI EDHE PËRTEJ RAJONIT

"Në qeverisjen e kryeministrit Edi Rama ka pasur afrim me Republikën e Serbisë, sidomos në vazhden e procesit të Berlinit. Në vitet 2014 dhe 2015 janë shkëmbyer dy vizitat e para reciproke në nivel kryeministrash që nga vitet 1940. Në vitin 2015 dy kryeministrit e dy vendeve hodhën idenë për krijimin e një organizate bashkëpunimi rajonal për të rinjtë, e cila filloi punën në vitin 2017 me seli në Tiranë", thuhet më tej në dokument.

"Qeveria shqiptare bën përpjekje për marrëdhënie të fqinjësisë së mirë. Pyetjet e hapura në raportet me Greçinë po bisedohen në mënyrë konstruktive që prej



Kryeministrit Edi Rama dhe Kancelarja gjermane Anxhela Merkel

vitit 2017. Shqipëria i ka mbështetur të gjitha vendimet e marrë në politikën e përbashkëta të jashtme dhe të sigurisë. Prej vitit 2009 Shqipëria është anëtare e NATO-s. Dhe për vitin 2020 synon të marrë në dorë kryesinë e radhës së OSBE-së, duke u rrekur kështu të marrë përgjegjësi përtej kufijve rajonalë", argumenton më tej qeveria gjermane.

BASHKËPUNIMI ME KOSOVËN

AFD bën pyetje edhe lidhur me idenë e bashkimit etnik të shqiptarëve, ose siç quan ajo "Shqipëria e Madhe". "Shqipërinë dhe Republikën e Kosovës i lidhin marrëdhënie të ngushta bilaterale. Shqipëria e sheh gjuhën dhe kulturën shqipe si një pikë kontakti për bashkëpunimin ndërkufitar, sidomos me Kosovën", përgjigjet Ministria e Jashtme.

Sipas informacioneve të qeverisë federale gjermane, në Shqipëri, nuk ka parti politike që mbështesin bashkimin e gjithë shqiptarëve etnikë në një shtet. "Në Kos-

ovë është lëvizja opozitare "Vetëvendosje" e vetmja që e mbrojnë këtë ide. Kushtetuta e Kosovës megjithatë e përjashton mundësinë e bashkimit me një shtet tjetër: Qeveria federale e ka bërë të qartë disa herë se ajo nuk mbështet ndryshime territoriale në Ballkan mbi

vende të tjera të rajonit, diskutohen vazhdimisht alternativat e mundshme, në rast se nuk do të ketë anëtarësim në BE. Nga ana tjetër është e qartë se Shqipëria synon anëtarësimin në BE dhe po bën reformat e nevojshme për të", përgjigjet qeveria. Gjithashtu, qeveria gjermane

BASHKIMI ME KOSOVËN

Sipas informacioneve të qeverisë federale gjermane, në Shqipëri, nuk ka parti politike që mbështesin bashkimin e gjithë shqiptarëve etnikë në një shtet.

man, qeveria i përgjigjet se nuk di që të ketë struktura ose tubime ekstremiste shqiptarësh në Gjermani. Por pranon se ndër anëtarë të simpatizantët e organizatave islamiste të gatshme për dhunë që vepron në Gjermani ka edhe individë me shtetësi shqiptare.

kanë qenë krimet e pronës, të lëndëve narkotike dhe të trafikimit. Nga 572 procedura hetimore të zhvilluara në këtë vit, 21 kanë qenë kundër grupeve të dominuara nga shtetasit shqiptarë, ndërsa 12 nga shtetasit e Kosovës. Kundër këtyre të fundit janë bërë hetime kryesisht për krime me lëndë narkotike, falsifikime dhe krime të pronës. Numri i shtetasve shqiptarë në hetim për krime të organizuara në vitin 2017 ka qenë 214, kurse ai shtetasve nga Kosova 195, nga gjithsej 8317 persona në hetim.

E pyetur se a financohen aktivitete ekstremiste shqiptare nga krimi i organizuar, qeveria gjermane përgjigjet se nuk është në dijeni. Së fundi, deputetët e AFD-së pyesin se sa është shuma e ndihmave për të cilat do të ketë nevojë Shqipëria si anëtare e BE-së? Qeveria gjermane përgjigjet se kjo shumë mund të llogaritet vetëm kur Shqipëria t'i ketë përmbyllur me sukses të gjithë kapitujt e negociatave të anëtarësimit.

"Alternativa për Germaninë" zë vetëm 12,6 për qind të vendeve në Bundestag, por, për shkak të qeverisë së koalicionit të madh mes CDU/CSU dhe SPD, është partia kryesore e opozitës. E krijuar në vitin 2013, AFD është e përfaqësuar në të gjitha parlamentet e landeve. Ajo është e vetmja parti e Bundestagut gjerman që është kundër anëtarësimit të vendeve të Ballkanit në BE. Në tetor ajo doli me një propozim që në vend të perspektivës së anëtarësimit shtetevetë të Ballkanit Perëndimor t'u ofrohet mundësia e krijimit të një Unioni të Ballkanit Perëndimor.

KRIMET

Nga 572 procedura hetimore të zhvilluara në këtë vit, 21 kanë qenë kundër grupeve të dominuara nga shtetasit shqiptarë, ndërsa 12 nga shtetasit e Kosovës. Kundër këtyre të fundit janë bërë hetime kryesisht për krime me lëndë narkotike, falsifikime dhe krime të pronës. Numri i shtetasve shqiptarë në hetim për krime të organizuara në vitin 2017 ka qenë 214, kurse ai shtetasve nga Kosova 195, nga gjithsej 8317 persona në hetim.

bazën e kritereve etnike."

E pyetur rreth deklaratave të kryeministrit shqiptar Edi Rama në prill 2018 në lidhje me mundësinë e bashkimit me Kosovën, nëse mbyllet portat e BE-së, qeveria përgjigjet: "Në Shqipëri, sikurse edhe në

mane thotë se nuk është në dijeni për aktivitete "nacionalistësh shqiptarë" në Mal të Zi dhe Greçqi.

KRIMET KRYESORE: VJEDHJET, DRUGA DHE TRAFIKIMI

Pyetjes në lidhje me ekstremistë shqiptarë në Gjermani,

E pyetur për kriminalitetin e shtetasve nga Shqipëria dhe nga Kosova në Gjermani, Ministria e Jashtme i referohet të dhënave të Entit Federal të Kriminalistikës, sipas të cilit për vitin 2017 krimet kryesore të bëra nga shtetasit shqiptarë

PAKTI SHQIPERI-GREQI KUFIJTE TOKESORE

Eksperti i sigurisë dhe ish-drejtori i Policisë Kufitare publikon 2 dokumentet e viteve 1985 dhe 1995

Besnik Baku: Marrëveshjet Shqipëri-Greqi për mirëmbajtjen e piramidave të kufirit tokësor

"Takimet e komisioneve, grekët tentuan të anashkalojnë konventat ndërkombëtare dhe protokollin e Firences"

Nga Besnik Baku

Sic kam thënë edhe më parë kisha bërë një marrëveshje me vetveten, që nuk do të prononcohesha më për problemet e kufirit me Greqinë, pasi i kam shteruar gjithë argumentet historike dhe juridike për këtë çështje, por pas publikimit të intervistës së ish-ministrit të Jashtëm grek Nikos Kotzias, sipas të cilit "ka forca në Greqi - duke përfshirë edhe ushtrinë greke - që nuk njohin kufijtë shtetërorë të Shqipërisë" dhe heshtjes që e shoqërojnë këtë deklaratë si në Greqi ashtu dhe Shqipëri, më tronditën dhe më nxitën të mos e mbaj marrëveshjen për të mos shkruar më.


Askush nuk i kërkoi shpjegime zotit Kotzias për deklaratat e tij, as ministri i Mbrojtjes Panos Kamenos, as Kryeministri/Ministri i Jashtëm, Aleksis Tsipras, madje as nuk dolën ta përgënjeshtrojnë.

Në Shqipërinë time jo se jo, as pozita e as opozita, as media, as akademiko-historianët, pasi janë të zënë me sherrnajtjen mes vedit.

Madje disa u përpoqën ta minimizonin këtë deklaratë, si jo serioze, por si reaksion i Kotzias ndaj Ministrit të Mbrojtjes, Panos Kamenos, i cili e detyroi të jepte dorëheqjen.

Ky qëndrim i saj nuk është rast i shikëputur, ai është në vazhdim e qëndrimeve dhe ngjarjeve të tjera, si: fondi sekret prej miliona eurosh që ishte në dispozicion të "shqiptarëve" kontribues në interes të jo-Shqipërisë, histeria antishqiptare e Bularatit, etj.

Singerisht habitem se si ka mundësi që fqinjët tanë (paraardhësit e të cilëve, i kanë dhënë kaq shumë kulturës evropiane)nuk kanë kuptuar ende frymën evrop-



Protokollin e vitit 1915

piane se barazia e shteteve, interesi i ndërsjellë, transparencja, respektimi i tërësisë territoriale, nderimi mes kombeve, respekti ndaj kulturave, janë themelet e një fqinjësie të mirë mes shteteve.

Nuk dua ta besoj se në Greqi vazhdon të bashkëjetoj shteti legal me para-shtetin e nacionalizmit grek, i cili vazhdon të ushqehet nga sirenat e nacionalizmit dhe urretjes, pasi mendoj se popujt kufitarë nuk rrinë në shpinë, por përballë njëri-tjetrit. Ata e shohin njëri-tjetrin në sy, kuptohen me shenja dhe japin e marrin mes tyre. Deklarata e Kotziasit (por jo vetëm), tregon se para-shteti në Greqi, ekziston ende, paraletisht me shtetin dhe ndonjëherë edhe brenda tij. Sic thotë dhe një gazetari i njohur, që njeh problemet e Greqisë "Shteti nuk guxon të ndeshet me para-shtetin

edhe pse e mban nën kontroll atë, ngaqë kjo mund të shpinte në një lloj lufte civile të hapur apo të heshtur. Nuk ndeshet, gjithashtu, sepse shteti 'ndan' me para-shtetin, në një masë të madhe, dogmën e nacionalizmit supremacist".

Ndaj për të sqaruar edhe një herë këtë çështje, po përpiqem që shkurtimisht të jap një tablo dhe paraqes argumente për ekzistencën, njohjen dhe respektimin e kufirit shqiptaro-grek, jo vetëm nga të dy palët, por edhe subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare. Madje asnjëherë nuk rezultoj që të ketë pasur konstatim institucional prej qeverive greke.

Historikisht fillësat e veta si kufi shtetëror, datojnë para krijimit të shtetit shqiptar, pas Kongresit të Berlinit të 1878 dhe Traktatit të Shën Stefanit.

Vazhdojnë me vitin 1912,

kur Konferenca e Ambasadorëve në Londër, i kushtoi shumë kohë caktimit të këtij kufiri. Në mënyrë të padrejtë Shqipëria u konsiderua vend humbës i luftës dhe trojet tona nuk mund t'i shpëtonin pasojave të disfatës së Turqisë, duke injoruar faktin se Shqipëria jo vetëm nuk kishte asnjë lidhje me luftën e Turqisë me shtetet e Ballkanit, por përkundrazi kishte dhënë një kontribut të paneglizueshëm në këtë luftë.

Më 11 gusht 1913 Konferenca e Ambasadorëve miratoi propozimin e kryetarit të Konferencës, E. Grey, mbi kufirin jugor të Shqipërisë, i cili përcaktonte se: "Shqipërisë i mbetet Korça e Szani, Greqia merret Janinë". Kjo ndarje e këtij kufiri u bë në dëm të Shqipërisë, jo sipas parimeve etnografike, historike, ekonomike etj.

Ministri amerikan në Greqi në atë kohë do ta quante këtë plan "një mrekulli e paaftësisë", "një skemë absolutisht të papajtueshme", "një lëmsh gjërash të paqëndrueshme". Ishte kjo padrejtësi historike ndaj një prej popujve më të vjetër të Evropës, që do të sillte ndeshje, gjak, mëri, dhunë dhe lot deri në fillimin e shekullit të XXI, që detyroi Imzot Gjergj Fishtën të akuzojë: "Uh! Evropë, ti kurva e motit!/ Që i re mohit, besës së Zotit!/ Po, a ky asht sheji i qytetnisë?/ Me da token e Shqypnisë."

Është vet kryetari i kësaj Konference zoti Eduard Grej, që ka pohuar padrejtësinë e madhe që u bë ndaj Shqipërisë: "...Unë di fare mirë se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo zgjidhje në shumë pika do të japë shkas për kritika të forta..."

Kjo ndarje e kufirit u rikonfirmua me Protokollin e Firences të Fuqive të



Médha në 27 janar 1925 për kufijtë e Shqipërisë me Greqinë dhe përfundoi më 30 korrik 1926 nga Konferenca e Ambasadorëve të Fuqive të Médha, në Paris me "Aktin Përfundimtar të Delimitimit të Kufijve Shqipërisë". Duhet theksuar se ky akt detyrues është vendosur unanimisht dhe firmosur pa asnjë vërejtje nga përfaqësuesit e Shqipërisë, Greqisë dhe Jugosllavisë.

Edhe pas këtyre akteve qeveria greke nuk i rreshti përprjekjet rivendikuese, për ta ndryshuar këtë kufi, si në Konferencat e Paqes në vitin 1919 ashtu dhe në vitin 1946 pas përfundimit të Luftërave Botërore, por pa rezultat.

Megjithatë qëndrimi i heshtur refuzues i Greqisë për njohjen e këtij kufiri vazhdoi edhe më pas.

Në vitin 1953 qeveria shqiptare i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, ku i propozonte qeverisë greke organizimin e një takimi të komisionit të përbashkët kufitar. Përprjekjet e qeverisë shqiptare për këtë qëllim vazhduan edhe në

vitet 1956 dhe 1959, por pa sukses, pasi qeveria greke refuzonte.

Pas rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike në vitin 1971, qeveria shqiptare me notë zyrtare, i ka propozuar më 10 maj 1972 qeverisë greke zhvillimin e bisedimeve për nënshkrimin e marrëveshjeve për rindërtimin e piramidave dhe vendosjen e shenjave të tjera kufitare. Edhe ky propozim nuk u pranua nga pala greke.

Në korrik të vitit 1985, u zhvillua në Athinë takimi i delegacioneve të specialisteve shqiptare dhe grekë, për të shqyrtuar mundësitë e riparimit të piramidave kufitare dhe për të shkëmbyer mendime për mënyrat a tjera të parandalimit dhe të zgjidhjes së incidenteve në kufirin shtetëror të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe të Republikës së Greqisë.

Delegacioni shqiptar kryesohet nga Drejtori i Kufirit Zoti Enver Pataj, kurse ai grek nga nënkolonel Rikollao Kulluris.

Nga ky takim u vendos




Nikos Kotzias

TAKIMI I KOMISIONIT

NE 1995
pala greke nguli këmbë që në Preambulën e Marrëveshjes nuk ishte e nevojshme t'i referohehim "dokumenteve ndërkombëtare, përkatësisht Protokollit Ndërkombëtar të Firences me Aneksat përkatëse të vitit 1925 për Kufirin Shqiptaro-Grek", dokumente që i posedonte



Rama Cipras



Protokollit i vitit 1995

të krijoheshin 3 grupe të përbashkëta pune me 12 vetë secili, me pjesëmarrjen e 1 oficeri, 4 ushtarëve dhe 1 ndihmësi, nga secila palë; të cilët kishin si detyrë:

a) Të regjistronin piramidat ekzistuese dhe numrat përkatës të tyre.

b) Të vlerësojnë dëmet që kanë pësuar piramidat dhe mundësitë e mënyrat e riparimit të tyre.

c) Të konstatojnë piramidat që mungojnë (të shkatërruara plotësisht).

d) Të përcaktojnë sektorët midis piramidave ku për shkak të natyrës së terrenit eventualisht mund të ndodhin incidente kufitare si dhe sektorët e pyllëzuar të vijës së kufirit".

Takimi i dytë i këtyre delegacioneve u zhvillua në Tiranë prej datës 26 deri me 30 nëntor 1985, ku: "Palët konstatuan se, nga 177 piramidat kufitare kryesore të kufirit shtetëror shqiptaro-grek, 19 prej tyre nuk u gjetën, 27 piramidave u është gjetur vetëm bazamenti, 18 janë dëmtuar mbi 50 për qind, 37 janë dëmtuar nën 50 për qind, kurse 76 duan

riparime të vogla. Grupet e përbashkëta të punës, konstatuan, gjithashtu, se nga rreth 270 km që është kufiri shtetëror shqiptaro-grek, rreth 145 km është i veshur me pyje e kaçube dhe, për arsye të konfigurimit të terrenit dhe të bimësisë, shumë pjesë të vijës së kufirit janë të paqarta dhe mund të bëhen shkak për incidente kufitare".

Në këtë takim pala shqiptare i dorëzoi palës greke "Projekt marrëveshjen për parandalimin dhe zgjidhjen e incidenteve kufitare".

Mbledhja e tretë e këtyre delegacioneve u zhvillua në Janinë prej datës 25 deri më 29 shtator 1989, ku për punimet e kryera u hartuan dhe u nënshkruan procesverbale, në të dyja gjuhët (shqip e greqisht).

Në këtë takim për projektin e marrëveshjes për parandalimin dhe zgjidhjen e incidenteve kufitare dhe vendosjen e disa rregullave të përkohshme, deri në përfundimin e kësaj marrëveshje, nga pala greke u tha se nuk janë në kompe-

tencën e delegacionit grek dhe do t'i transmetohen organeve kompetente nëpërmjet dërgimit të këtij Protokollit.

Mbledhja e katërt u zhvillua më 14 shkurt 1991 në Tiranë, në të cilën delegacioni shqiptar, përsëriti kërkesën për përfundimin e marrëveshjes për zgjidhjen e incidenteve, por delegacioni grek njoftoi se projekti shqiptar i dorëzuar në vitin 1985, është akoma duke u studiuar. Ai mori përsipër që të vejë në dijeni qeverinë greke për këtë propozim të përsëritur.

Më 9-11 shtator 1992 në Janinë zhvillohet mbledhja e pestë. Në këtë takim pala shqiptare kërkoi përdorimin e dokumenteve ndërkombëtare që nga Protokollit i Firences të 17 dhjetorit 1913 dhe atij të 27 janarit 1925, por pala greke iu shmang kësaj kërke dhe kërkoi që Shqipëria t'i drejtohej palës greke në rrugë diplomatike, ku të kërkonte njohjen e dokumenteve juridike-ndërkombëtare për caktimin e kufirit.

Në vitet 1994-1995, në kuadër të Komisionit të

Përbashkët Shqiptaro-Grek, u formua Komisioni i Përbashkët për çështjet e kufirit dhe të mbrojtjes.

Në të bënin pjesë ekspertë ushtarakë me nivel të lartë teknik e profesional, si dhe përfaqësues të dy Ministrive të Jashtme. Në takimin e dytë zyrtar në Athinë, ku do të finalizohet dokumenti bazë, i cili ishte një Protokoll Marrëveshje kuadër për t'u zbatuar në parim nga të dy vendet në terren, ku pala greke gjatë bisedimeve në Ministrinë Greke të Mbrojtjes shpalli një qëndrim dhe koncept të papranueshëm e jashtë realitetit të gjërave.

Në dallim nga takimi i parë në Tiranë, në Athinë pala greke e nisi pozicionimin në bisedime me një formulim jo të saktë. Ajo iu përmblodh pikëpamjes që dokumenti të quhej "Përcaktimi i Vijës Kufitare". Kjo u kundërshtua nga pala jonë dhe palës greke iu bë thirrje menjëherë që të korrigojë përdorimin e termave, sepse ne nuk ishim mbledhur të përcaktionim vijën e kufirit, por për të lidhur një Marrëveshje për

Riparimin dhe Mirëmbajtjen e Vijës Kufitare Tokësore. Mbas kësaj ndërhyrje serioze, pala greke kërkoi ndjesë se "u shprehëm gabimisht dhe u keqkuptuam".

Por nuk mjaftoi me kaq. Ajo këmbënguli që në dokumentin e Protokoll Marrëveshjes të shënohej se riparimi i piramidave kryesore dhe dytësore të bëhej duke i identifikuar ato sipas vijës ekzistuese në vend rast pas rasti, duke ngulur këmbë që në Preambulën e Marrëveshjes nuk ishte e nevojshme t'i referohehim "dokumenteve ndërkombëtare, përkatësisht Protokollit Ndërkombëtar të Firences me Aneksat përkatëse të vitit 1925 për Kufirin Shqiptaro-Grek", dokumente që i posedonte secila palë.

Pas bisedimesh të gjata dhe të tensionuara pala greke pranoi formullimin të ekspertëve shqiptarë që punimet të kryhen "mbi vijën e kufirit shqiptaro-grek të njohur botërisht, në bazë të dokumentacionit teknik ekzistues", pra në përputhje me marrëveshjet dhe dokumentacionin ndërkombëtar që ekzistonte për të dy vendet për vijën kufitare tokësore.

Takimet e Komisionit Shqiptaro-Grek për çështjet kufitare dhe punimet për rindërtimin e riparimin e piramidave kufitare në kufirin Shqiptaro-Grek, vazhduan çdo vit dhe përfunduan në vitin 2006. Mirëmbajtja dhe riparimi i piramidave vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Vlen të theksohet se në kryerjen e këtyre punimeve u përdorën hartat e Protokollit të Firences, madje edhe në proces verbalit e firmosura nga të dy palët janë ruajtur të njëjta emërtime të sektorëve dhe numrave të piramidave.

Gjithashtu dua të përmend që procesverbalet janë të firmosura nga përfaqësues të lartë të ushtrisë greke.

Për punën e bërë në vite duhet t'i jemi mirënjohës personaliteteve që morën pjesë në kohë të ndryshme në këto komisione, si: Prof. Dr. Ksenofon Krisafi, Prof. Dr. Myslim Pasha, Ali Hamzait, Prof. Dr. Kosta Gazeli, Mihal Kallio; drejtorëve të Kufirit në vite që ishin kryetarë të delegacioneve, si: Enver Pataj, Haki Liçaj, Beqir Prega, Gëzim Goçi, Pjerin Ndreu, Albert Piloi, Bashkim Mustafa, Krenar Muça e Arjan Rugji, dhe në veganti topografëve të talentuar dhe patriot: Çelink Murataj, Prof. Dr. Myslim Pasha, Çarcan Dana, Selman Lleshi, Isak Rama, Edison Memelli.

Është detyrë e të gjithëve (grekë e shqiptarë) ta ruajmë e forcojmë fqinjësinë e mirë mes njëri-tjetrit, pasi ajo ka rënëjt të thella që nga lashtësia, kur Homerit në Iliadë na rrëfen se pellazgë, ilirë dhe grekë ishin

rreshtuar së bashku në Luftën e Trojës së Priamit; Herodoti shkruante për kullotat dhe bagëtinë e Apollonisë, për lumin Ao që rrjedh pranë vendlindjes sime; Aristoteli shkruante për qeverisjen e Epirit dhe Ilirisë.

Të gjithë duhet t'i jemi mirënjohës gjimnazit të famshëm Zosimea të Janinës, ku u shkolluan dhe morën dritën e diturisë rilindësit më të mirë shqiptarë, ata që e ngritën Shqipërinë. Duhet të marrim shembull nga bashkëpunimi shqiptaro-grek në revolucionin grek të vitit 1821, ku bashkë me heronjtë grekë, njëlloj si në kohërat antike, shkëlqyen arvanitasit Boçari, Xhavela, Bubulina, etj.

Është profetik parashikimi i një nga ideatorëve dhe ideologëve të Rilindjes shqiptare, poetit kombëtar Naim Frashëri "Interesat politike e të dy kombeve e do që gjithnjë Shqipëria dhe Greqia të jenë miq të pandarë. Por fazat historike që prej një shekulli e tëhu do të nxjerrë shumë pengime për një marrëveshje të vërtetë".

Në përfundim dua t'i kujtoj zotit Kotzias se kufiri shqiptaro-grek jo vetëm që njihet nga të gjithë, por është dhe i paprekshëm nga askush. Për këtë mjafton të lexosh nenin 1 të "Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së mirë dhe Sigurisë midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Greke" ku shprehet se: "Republika e Shqipërisë dhe Republika Greke shpallin për kushtimin e tyre ndaj parimit të paprekshmërisë së kufijve ekzistues, të njohur ndërkombëtarisht, në përputhje me Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit, dhe se vija kufitare midis dy vendeve do të jetë vijë kufitare paqe dhe miqësie. Ato deklarojnë respektimin nga ana e tyre e parimeve të sovranitetit, të tërësisë tokësore, të barazisë së të drejtave".

Ndaj nuk është koha për moskuptim, por për mirëkuptim, për nënshkrimin e dy marrëveshjeve të domosdoshme për kufirin; asaj për riparimin dhe mirëmbajtjen e piramidave dhe për zgjidhjen e incidenteve kufitare.

Jo vetëm grekët, që siç shkruan personaliteti i madh grek Seferisi: "kudo që shkojnë Greqinë e marin me vete, si një plagosje", edhe në shqiptarët kudo që shkojmë Shqipërinë e marin me vete, dhe jo vetëm si një plagosje, por edhe si një bregë, pasi nuk kemi mundur t'ja mbyllim dhe qetësojmë plagët. Pasi i jemi borxhli Shqipërisë, ashtu siç me dhimbje e shkruan poeti i madh dhe mikiu im Xhevhahir Spahiu "I kemi borxh vitit 13 që nuk i mbyllëm plagët"

*** Titulli i origjinalit: Kotzias, ushtria dhe e vërteta e kufirit shqiptaro-grek**

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



EMRAT/ 5 këstet e kompensimit që do të shpërndahen nga fondi i ALUIZNI-t

Pronarët që ndajnë 200 milionë lekë të reja në Tiranë e në rrethe

Agjencia e Trajtit të Pronave (ATP) njofton se ka përfunduar procesin e shqyrtimit për 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) kërkesa, të paraqitura nga subjektet përfitues, pronarë të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimet informale, që përfitojnë deri më tani kompensimin/shpërbllim në vlerë, në masën 70% të shumës së përgjithshme në të holla, të miratuar me Vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Procesi i shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe i shpërndarjes së fondit të kompensimit është bazuar në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.383, datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale", i ndryshuar, dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, në të cilët është përcaktuar masa e shpërndarjes së fondit të kompensimit në

Për 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) kërkesatë më sipërme, për të cilat ka përfunduar procesi i shqyrtimit nga ana e ATP-së, ka rezultuar se dokumentacioni i tyre është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.383, datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në

vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale", i ndryshuar. 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) kërkesatë e miratuara, përfitojnë këstin e parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë të kompensimit në të holla në një total prej 70% të vlerës totale të miratuar me VKM-të përkatëse.

Fondi financiar që shpërndahet nga ATP për këto 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) kërkesa, është në vlerën 203 614 601,15 (dyqind e tre milion e gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e një presje pesëmbëdhjetë) lekë. Të dhënat në lidhje me pasuritë që kompensohen dhe mbi gjeneralitetet e subjekteve përfitues jepen

në listën bashkëlidhur këtu! njoftimi. Agjencia e Trajtit të Pronave (ATP) njofton subjektet e interesuara se vlerat përkatëse për secilin përfitues do të jenë disponibël në llogaritë e tyre në bankat e nivelit të dytë pas përfundimit të procedurave të transfertave bankare në ditë në vazhdim.

Table with columns: Nr. renditje, Nr. Shërbime, Data, Emri, Prenimi, Subjekti përfitues, Qarku, Vlera, Shërbime, Nr. Renditje. Rows include names like BUJAR, NEM, MURATAJ, FIER, etc.

Table with columns: Nr. renditje, Nr. Shërbime, Data, Emri, Prenimi, Subjekti përfitues, Qarku, Vlera, Shërbime, Nr. Renditje. Rows include names like FLAMUR, LUTFI, HOKHA, DURRES, etc.

Table with columns: Nr. renditje, Nr. Shërbime, Data, Emri, Prenimi, Subjekti përfitues, Qarku, Vlera, Shërbime, Nr. Renditje. Rows include names like ZANA, LLAZAR, STATHI, ELBASAN, etc.

EKSPOZITA

Arti pamor dje dhe sot, një diskutim në Akademi

Galeria FAB çel "Proces"-in, 25 emra të njohur pjesë e nismës

Fatmira Nikolli

Tri javë jetë artistike do të jenë më të pranishme se kurrë në tri hapësira galerish për të diskutuar mbi artin pamor me vizitorët dhe njerëzit që e duan artin pamor.

Në Tiranë, pedagogët e Fakultetit të Arteve të Bukura kanë çelur një ekspozitë të përbashkët me titullin "Proces". 25 emra të njohur të artit pamor bashkëkohor janë bërë bashkë në ngjarjen kulturore "Proces". Krahas prezantimit të veprave të artit me qasje të qartë social-politike, ata kanë ngritur siparin e një procesi diskutimi të artit pamor dje dhe sot. Janë bërë shumë bashkë për të folur mbi atë që ishim e atë që jemi.

Albes Fusha, Arben Bajo, Ardian Isufi, Ardian Pepa, Edison Çeraj, Edmond Gjokopulli, Ergys Krisiko, Ermal Baboçi, Fatmir Miziri, Florian Haxhihyseni, Gazmend Leka, Harri Aleks, Kreshnik Xhiku, Merita Selimi, Mikel Temo, Orlis Vathi, Sadik Spahija, Shpëtim Kërçova, Viktor Ferraj, Vladimir Llakaj, Vladimir Myrtezai - plot 25 artistë të cilët janë edhe pedagogë vijnë ndryshe, jo me një ekspozitë, por me një proces diskutimi mbi artin. Kuratori Ilir Kaso këtë shteg procesi e ka nisur simbolikisht me Gjon Milin fotografimin e njohur me origjinë shqiptare për këtë arsye. Dekani i Arteve të Bukura Ardian Isufi është shprehur se kjo është një bienale e mirëfilltë arti e shtrirë edhe në dy hapësira të tjera ekspozimi. Simbolika e artit, medimet janë të ndryshme. Ata përcjellin shqetësime sociale, politike me gjuhën e artit. Por në këtë proces nuk mungon edhe "in memorie" për ata të cilët nisën rrugëtimin artistik me shenja të modernizmit edhe në kohë të vështira.

"Procesi" ndërthur procesin krijues me atë pedagogjik dhe shkencor duke mundësuar simpoziume, punëtori dhe biseda të hapura mbi çështje të artit dhe pedagogjisë. Ky format u jep mundësinë për pjesëmarrje jo vetëm pedagogëve që merren me studime shkencore, por edhe studentëve që kanë mbaruar Universitetin e Arteve dhe vazhdojnë krijimtarinë e lirë apo studimet e tyre diku tjetër. Gjithashtu, ky aktivitet i shërben marrëdhënies pedagogjike duke premtuar punën krijuese dhe kërkimore një publiku që do të ketë mundësinë të njihet me figura të njohura në historinë e artit shqiptar dhe atë botëror. Këtë vit, është zgjedhur artisti i



mirënjohur në fushën e fotografisë botërore Gjon Mili, i cili do të jetë personazhi honorifik për këtë edicion. "Ne u frymëzuam nga një seri fotografish që Mili ka realizuar në vitin 1949 dhe vendosëm të zgjedhim fjalën 'proces' për ndërtimin e këtij aktiviteti, duke menduar se procesi krijues është elementi thelbësor në veprimtarinë artistike dhe atë shkencore. Pavarësisht hapësirës optimale që ofron galeria FAB, kemi ndërtuar një hartë me dinamikë më të gjerë veprimi duke bashkëpunuar me galeritë Kalo dhe Zenit. Duke u zgjeruar në hapësirë, ky aktivitet kërkon gjithashtu, të zgjerohet edhe në

kohë, ndaj kemi ndërtuar një program të mirëdetajuar, i cili do të informojë publikun për vendin dhe ngjarjen e radhës", tha Ardian Isufi. Aktiviteti kulturor mbahet përgjatë ditëve 26 nëntor - 16 dhjetor 2018.

TEMA

Temat që diskutohen çdo ditë janë të ndryshme. Nis nga Fotografitë shqiptare në Amerikë (Një vështrim historik) nga Dr. Ermir Hoxha, të Bisedë e hapur për çështje të hapura nga Primo Shllaku. Me 6 dhjetor Alumni - Leksion - performancë "STUDY ART for FUN or FAME" vjen nga Donika Çina. Raportet e përmbysura mes imazhit dhe fjalës janë



në fokus nga Jolka Nathanailli-Penotet & Gian Francesco Arzente ndërsa dokumentar si program alternativ në Atelieren e Grafikës mbahet më 8 dhjetor nga Ilir Kaso & Ardian Isufi. Një tjetër dokumentar nën titullin "Në ndërtim e sipër" sa i takon vizionimit audioviziv në Atelieren e Multimedias është nën kujdesin e Vladimir Myrtezait. Referati "Programi Ikonografik i Kishës së Shën Mëhillit në Vitkuq" vjen nga Rosela Dhimgjini, teksa Zef Paci sjell një hulumtim mbi arkivin fotografik të ATSH "Mbi jetën e përditshme politike". Edison Çeraj mban një leksion të hapur mbi "Rolin e kuratorit", ndërsa Fioralba Stalka flet për Edukimin artistik, (Procesi krijues si bazë për zhvillimin e veprimtarisë artistike pamore). Ledia Kostandini & Ilir Kaso ndalen me 15 dhjetor tek tema e shkëmbimit akademik me idenë e të mësuarit nga eksperiencia.

"STREHA MES REVE", DY FE E NJË TEMPULL

Dy fe, një tempull! Drama e vendosur në Shqipërinë thellë rurale dhe tradicionale trajton një ngjarje shumë të pazakontë: unitetin mes myslimanëve dhe katolikëve të cilët ndajnë mes tyre një xhami-kishë të përbashkët. Por a është e mundur? Nga Black Nights Film Festival në Tallin, shkruan DMovies për filmin "Streha mes reve" të Robert Budinës. Kritika vijon me përshkrimin e filmit. Besniku jeton në mal me familjen e tij, në një fshat të vogël diku në Shqipërinë Veriore. Pamja është asgjë më pak se spektakolare. Peizazhi i thepisur është i gjelbër dhe i bardhë, pjesërisht i mbuluar nga debora, pjesërisht i mbuluar nga bimësia e harlisur. Dhitë janë kudo, dhe duket se janë më të shumta në numër se njerëzit. Ata u sigurojnë qumështin, mishin dhe lëkurën e tyre ven-

dasve, të cilët kanë një jetë të pasigurt, por relativisht të qëndrueshme dhe të kënaqshme.

Retë në titullin e filmit kanë një rëndësi të dyfishtë. Ato i referohen maleve ku ndodh historia, majat e tyre shpesh mbulohehen me retë dhe kërkimit për një terren më të lartë moral, një lloj qielli ekumenik. Babai i sëmurë i Besnikut është mysliman (komunist), vëllai i tij Alban konvertohet ortodoks grek, ndërsa nëna e tij ishte katolike. Besniku nuk ka mundur të martohet me dashurinë e jetës së tij për arsye politike. "Por mbi të gjitha, duket se fshatarët ende janë të ndikuar nga regjimi komunist i Enver Hoxhës, i cili ndalonte të gjitha llojet e fesë. Një ditë, Besniku merr hapin e pazakontë të gërvishtjes së murit të brendshëm të xhamisë, nën të cilin zbulohet muralla katolike. Dy ekspertet femra nga instituti i monumenteve vijnë për të vlerësuar dhe rregulluar muralen. Pastaj vijnë

lajmet tronditëse. Xhamia më pak se gjashtë shekuj më parë (deri në 1470) ishte kishë. Pak a shumë si Hagia Sofia në Stamboll. Dhe për një kohë të gjatë, myslimanët i lejuan banorët katolikë që të praktikonin fenë e tyre në xhami një herë në javë", shkruan DMovies. Ky ishte një gjest politik nga turqit e atëhershëm, të cilët dëshironin të nxirrnin në pah tolerancën e tyre fetare. Shqipëria u bë shtet i pavarur 106 vjet më parë, më 28 nëntor 1912 (në fakt, Streha Mes Reve u shfaq në Black Nights Film Festival në ditën e Pavarësisë së Shqipërisë). Vendasit myslimanë vendosin ti dhurojnë një "degë ulliri" komunitetit katolik dhe ta rihapin xhaminë një herë në javë për besimin e krishterë. Propozimi pritet sa me entuziazëm, aq

edhe me përqeshje nga banorët. Në njëfarë mënyre, kjo ide jo shumë e zakonshme është e lidhur me dëshirën personale të Besnikut mbi lirinë fetare. Ai është fjalëpakë, dhe nuk është gjithmonë e lehtë të zbulohen qëllimet e tij. Ndoshta jo rastësisht, njeriu i qetë dhe i turpshëm fillon një romancë me një nga femrat e ardhura në fshat si të donte të vlerësonte dëmin që ai i bën vetvetes. Streha Mes Reve është një dramë delikate dhe fisnike mbi arritjen e lirisë personale dhe atyre fetare. Streha Mes Reve është duke u shfaqur në konkursin e edicionit të 22-të të Black Nights Film Festival të Tallinit, i cili po zhvillohet tani. DMovies janë të ftuar si mysafirë të veçantë.

E DIEL

2 Dhjetor
2018



NGA PROF. DR.
BARDHYL DEMIRAJ

Ku dhemb dhëmbi, vete gjuha! Është një përvojë popullore kjo që e dëgjojmë, e lexojmë dhe e përfjethojmë shpesh, sidomos kur jeshim në kapërcyell të moteve, bash kur e ndjejmë si nevojë të brendshme e të domosdoshme me u rrëfyer për jetën e jetuar në vetvete sikurse, madje sidomos, detyrimet ndaj saj, duke ngërthyer kështu angazhimin e sekujt në ato rrethe intelektuale e shtresa sociale-kulturore ku bën pjesë. Parë nga kjo perspektivë marrëdhëniet e Martin Camajt me klerin katolik nuk mund a

duhet të kenë qenë sipërfaqësore. Mjafton të përmendim me ketë rast: formimin e tij shkollor-intelektual si *nxanës* i Shkollës së Jezuitëve në Shkodër, si doktorues me “Mesharin” e Gjon Buzukut,

si ihtar dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Mentorit të kulturës shqiptare në mërgim, At Zef Valentinit e jo më pak si mik i kahershëm dhe i vazhdueshëm i aradhesë së klerikëve shqiptarë e arbëreshë

në kohën e tij, ndër ta: At Daniel Gjeçaj, At Vinçenc Malaj, P. Francesco Solano, At Luigi Marlekaj, At Paulin Margjokaj etj.

Ndjesinë e brendshme e të domosdoshme të një rrëfimi të fundit për

këto marrëdhënie e përfjethojmë në një letër të gjatë që Martin Camaj i shkruan mikut të tij Gjon Sinishtës më 27 mars 1991 e që po ia përcjellim lexuesit të “Milosao” me lejen e së vejës Dr. Erika Camaj. Bëhet fjalë në radhë të parë sigurisht për një kumt vetëmbrojtës të natyrës biobibliografike që hapet dhe mbyllet mirëfilli me dëshmi jetësore të mirëqëna kundrejt “gojëve të liga”, strehëse dhe mohëse po-shqiptare. Gjithsesi shprehim bindjen që sekush prej nesh do të përfjethojë mes rreshtash shumë më shumë, madje sidomos rolin e amëshuar të klerit katolik në angazhimin kulturor dhe politik të mërgatës intelektuale shqiptare në Perëndim përgjatë gjithë gjysmës së dytë të shek. XX.

→ Vizion në faqen 14

Tirana-mahnia e Rezarta Delisulës

Duhet të ketë qenë e paimagjinueshme asokohe për gazetaren e re Rezarta Delisulën, që do vinte një ditë, njëzetë vite më vonë t'i kushtohej qytetit të saj. Por, jeta, ashtu si të përplas me kapriçot e veta të afron dhe me destinat. Për vite me radhë, përmes rubrikave që krijoi dhe mbi të gjitha mbulimin që i bëri çdo caku dhe pragu të kryeqytetit, ajo tregoi jo thjesht konceptin e saj për qytetin por edhe dashurinë

e madhe për vendlindjen e saj. Mbi të gjitha ajo diti të lexoj kumtet që ky qytet përçoi ndër vite për tiranasit përmes shpirtit të madh dhe mbi të gjitha dashurisë humane. Një nga këto mesazhe arriti të lexojë mirëfilli Rezarta, që tashmë nën petkun e gazetares së njohur të socialës dhe redaktores me përvojë, t'i kushtohej qytetit të saj me botimin e fundit Tirana-mahnia.

→ Vizion në faqen 20

Në këtë numër: MARTIN CAMAJ, BARDHYL DEMIRAJ, MILJENKO JERGOVIÇ, FASLLI HALITI, GJELOSH GJOKAJ ETJ.,

E

EPISTOLAR

Para pak kohësh, studiuesi i njohur Bardhyl Demiraj, na kish premtuar botimin e një letre nga arkivi i Camajt. Mund ta quajmë edhe rrëfimin e tij të fundit, meqë është vërtet letra e fundit e gjatë e tij, ku bën një rekapitullim të sjelljes së tij ndaj klerit. Duke cituar Profesor Demirajn, qëllimi i afrimit, është se: “Më shumë se sa rrëfim, shkrimi për mua ka më shumë rëndësi se skicon pak a shumë organizimin sado të brishtë të mërgatës intelektuale shqiptare, dhe prurjet e saj në këtë drejtim”...

Marrëdhëniet e Martin Camajt me klerin katolik

- në një letër dërguar Gjon Sinishtës më 27 mars 1991 -

NGA MARTIN CAMAJ

München, 27 marc 1991
I dashtuni Gjon,

megjithëse kjo letër ka me të mbërritë me vonesë t'uroj Pashkët me familje edhe në emën të Erika që sot punon për nja disa orë. Mora thirrjen për kremtimet në rastin e ardhjes së Dom Simonit [= D. Simon Jubani - B.D.]: faleminderës fort! Në kushte tjera do të kishim ardhë edhe na. Takim i paharueshëm për ju!

Me randësi nr. AMERIKA kushtue Shqipnisë. Nji nr. po e deponoj në bibliotekën universitare.

Mbasi do të kesh rastin me kuvendë me Dom Lazrin ti ke me ia shpjegue përngëshëm gjendjen e rolin e secilit nesh gjatë kësaj kohe të mnershëm për klerin e

Situata e emigracionit dhe kleri me shtë të Camajt

Kur pata mbërritë në Romë në qershor të 1956, isha fare i demoralizuem e me kujtime të freskta të terrorit komunist; shqiptarët e emigruem më parë, si duhet, të ndamë e të përçamë. Mbas takimeve të shumta me Prof. Koliqin, Patër Valentinin e P[atër] Rozën që atëherë luente rol të madh ideologjik social në Itali, u dha kjo analizë: kleri katolik me qendër në Shkodër tash qinda vjet u përqendruer apo zhvilloi aktivitetin e vet në tri drejtime: a) mbajtja e propagimi i fesë për mes klerit me të gjitha organizatat e veta (klerikale e laike); b) mbajtja gjallë e traditës kulturore; c) përforcimi i aktivitetit politik ku përfshihej edhe shlirimi i vendit prej komunizmit po ashtu si gjatë okupacionit turk (kjo e fundit teze e Valentinit).



Martin Camaj

popullatën katolike nën stalinizëm për një gjysëm shekulli. Jam i sigurtë se askush prej nesh nuk ka me ia sqarue punën si ti, dhe nuk do t'isha zgjatë më tepër në këtë letër, po mos me u pasë dhanë ai mendim negativ për mua se nuk paskam qenë shprehë në lidhje me vuetjtet e masakrimet e katolikëve në Shqipni, as me gojë, as me shkrim, si më shkruen ti në letër. Sigurisht nuk do të kisha reague kundrejt këtij pohimi, megjithëse dhemb i thanun prej kujdo. Po shfrytëzoj rastin e ardhjes së Dom Simonit te ju, në S[an] Francisco, në mënyrë që ta lexoni bashkë këtë letër. Ky pohim që shprehet kundër meje nuk asht aspak i vërtetë, sikur nuk ashtë i vërtetë se paskam pasë vdekë para nja 35 vjetësh si ka kujtue familja ime në Dukagjin. Nuk ashtë e vërtetë se s'qenkam marrë me politikë gjatë kësaj kohe, po me çfarë politike?

Kur pata mbërritë në Romë në qershor të 1956, isha fare i demoralizuem e me kujtime



Gjon Sinishta dhe Papa Gjon Pali

të freskta të terrorit komunist; shqiptarët e emigruem më parë, si duhet, të ndamë e të përçamë. Mbas takimeve të shumta me Prof. Koliqin, Patër Valentinin e P[atër] Rozën që atëherë luente rol të madh ideologjik social në Itali, u dha kjo analizë: kleri katolik me qendër në Shkodër tash qinda vjet u përqendruer apo zhvilloi aktivitetin e vet në tri drejtime: a) mbajtja e propagimi i fesë për mes klerit me të gjitha organizatat e veta (klerikale e laike); b) mbajtja gjallë e traditës kulturore; c) përforcimi i aktivitetit politik ku përfshihej edhe shlirimi i vendit prej komunizmit po ashtu si gjatë okupacionit turk (kjo e fundit teze e Valentinit).

E. Roza dhe unë mbrosim theksimin e aktivitetit kulturor. Unë thashë se e kam vendosë të ndjek një karrjerë universitare, specializim “albanologji”. Sfaqja se isha i lidhun për letërsinë kreative e se dosha me mbetë shkrimtar shqiptar. Për t'i dalë qëllimit e kisha vendosë që mos të ndahem prej gjuhës shqipe të cilën do ta bësha objekt studimi: në atë kohë merrresha intesivisht me gjurmimin e teksteve të vjetra gegë (kisha punue dy vjet nën drejtimin e Prof. Henrik Bariae në dizertacionin mbi “Mesharin” e Buzukut dhe me këtë temë doktorova ma vonë në Romë). Koliqi ishte njeri me personalitet të theksuem e sidomos prej më të riive si isha unë, në atë kohë (më vonë pat ndrrue sidomos mbas nisjes së botimit të “Shëjzat”), andaj donte që unë të vijosha karrjerën letrare e vetëm letrare, ashtu si letrarët rumunë në Francë, rusë në USA etj. etj. Prof. Koliqi ka qenë gjithmonë i bindun se “vokacioni” im qenka vetëm letërsia.

Por mos me e çue gjatë, në Romë kam studiue edhe një herë tjetër, 4 vjet ku kam edhe doktorue. Gjatë kësaj kohe mbas sa diskutimesh u themelue revista “Shëjzat”, meritë kryesore e Koliqit që kishte eksperiencë të gjatë në këtë lamë. Si thonte P. Valentin vijim i “Lekës” (Jo i “Hyllit të Dritës”), ndoshta për të na qitë në mend Koliqit e mue se ishim nuanës të shkollës së Jezuëve ...

Do vu në dukje se gjatë këtij bashkëpunimi ka pasë edhe pakënaqësi mes të dy palëve, Koliqi e Valentinin në anën e unë në tjetrën: sidomos kur u transferova në Gjermani, merrresha çdo numër të revistës tue mbajtë për një minut në dorë para se me e hapë, me frigë se do të gësha ndonjë shkrim të papëlqyeshëm në të. Profesor Koliqi ishte njeri politik me mish e me shpirt, shpirt facioz, sidomos në kontekstin partiak të emigracionit.

Merita e revistës “Shëjzat” kryesore ka qenë ajo e vijimit të traditës kulturore katolike të Shkodrës, kryekreje (në retrospektivë) vazhdimësia e gëgenishtes si variantë letrare. Prej 1952 e kam ndjekë kambë për kambë zhvillimin apo imponimin e tosknishes si gjuhë zyrtare. Nuk kemi polemizue fort, por jemi përpjekë ta perfeksionojmë gegnishten, tue u mbështetë në tek-

...nga numri i shkuar

Shkrimi kryesor i këtij numri i kushtohet Parashqevi Qiriazit dhe kishte të bënte me himnin e Alfabetit që është huazuar nga Kolegji i Yale. Në vitin 1909, Parashqevia shkroi "Himnin e alfabetit", botoi një abetare me alfabetin e ri, si edhe themeloi shoqërinë kombëtare për gjuhë, "Yli i Mëngjezit". Miku ynë Hosaflook hedh idenë se zonja e cila hartoi tekstin mori dhe idenë për Himnin prej kolegjit amerikan protestant për vajza në Stamboll Constantinople Women's College (ku Sevastia u diplomua më 1891). Ai hamendësoi se pedagogët amerikanë të këtij kolegji e kishin sjellë në Stamboll këngën e Kolegjit Yale për të frymëzuar studentet dhe se Parashqevi Qiriazit duhet ta ketë dëgjuar e kënduar këngën, që e frymëzoi. Pati një gabim që u rregullua në minutën e fundit nga redaktori dhe layout. Redaktori shtoi një shkrim për librin duke shtruar idenë se të gjithë, pra, njerëzit që merren me librin janë fajtorë për mos leximin, ndaj më e mira gjë që mund të thuhet në këto kohë është të heshtësh, të veprosh dhe të mos presësh. Duhet që vetë njerëzit e librit të tregojnë sesa mund ta kthejnë këtë frymë negative dhe të trandin atë shifrën e frikshme të 1 milion njerëzve që nuk lexojnë..., shtoi më pas.

Arian Leka na solli një esse për poezinë e Eizenger, që ishte rezident në Shtëpinë e Shkrimtarëve POETKA, dhe shkroi se kjo poezi kërkon shumë kujdes sepse lënda e vet del nga kaosi i jetëve tona. "Ky listim i padobive tona, i mburrjeve, i mendjelehtësisë duket se

na tremb. Edhe pamja e pazakonshme një poeti që mban shënim jetën tonë në përfaqësimet e veta të ulëta na tremb...", shkroi ai. Admira Poçi kishte punuar shumë mirë në përkthim dhe është treguar shumë modeste në të gjithë shfaqjen e saj. Profesor Rexhep Ferri na solli një esse në natyrën e vet të zakonshme, ku duket se mungon elementi kohë dhe del në pah fryma e identitetit shqiptar. Veçse nuk është e lehtë për ta lexuar, pasi autori duket se shkruan më shumë me një regjistër tejet të ngatërruar". Tatjana Haxhimihali na solli një shkrim për Mimoza Hafizin, duke përshkruar ndjeshmërinë artistike të autores, që bëri një sprovë në një zhanër shumë të vështirë të romanit fantastiko-shkencor. Kemi mall për një shkrim që të bëjë një kritikë qoftë dhe pozitiv për një libër, por kjo nuk ndodh aspak. Lazër Stani përcolli një gjë interesante ndaj romanit të Zija Çelës dhe faktit sepse romani i tij i fundit duhet lexuar, "pasi, sipas tij, nuk të zhgënjnë në asnjërin nga krijimet e tij, qofshin tregime të shkurtër prej disa faqesh apo romane qindra faqesh. Mjafton të lexosh disa paragrafë për të kuptuar se sa madhështore e magjepsëse është gjuha e shkruar, se çfarë bukurie tronditëse dhe imponuese bart në vetvete fjala, sa urtësi dhe dije universale ruhet në kodet e saj...". Në përgjithësi numri ishte i mirë, por kishte nevojë për më shumë kujdes në faqosje. Redaktori duhet të jetë më skrupuloz në aspektin teknik të problemit. Që do të thotë kopsjtin përfundimtare të librit.



Prof. Gradilone, Mr. Asim Jakova, znj. Camaj, Dr. Martin Camaj, Papas Solano, Papas Tamburi, Prof. Ernest Koliqi

stet e vjetra tona, tue i dhanë gënishtes vendin që i përket në kurset universitare. Pa modesti e për hir të vërtetës shfaqsi se kontinuitetin e përdorimit të gënishtes letrare në poezi, prozë artistike dhe ekspozitive (në këtë të fundit s' do harrue kontributi i revistave të emigracionit dhe mbas 1972), mbas mbylljes së "Shëjzat" (1975) me plot vetëdije e çova përpara unë: vepra e fundit letrare në këtë variantë të shqipes ashtë *Palimpsest* (München, Neë York 1991). S' po hy me lëvdue veten në gjurmimet gjuhësore, por po vë në dukje *Albanian Grammar* që përdoret si tekst kryesor kudo në Prendim në mësimin e shqipes në universitete, bile dhe në Bashkimin Sovjetik.

Tue kthye prap në fillim: jam përgjendur në një pikë, pikrisht në pikën b) (mbajtja gjallë e traditës sonë kulturore).

Pika a) (shërbimi apostolik në emigracion) mbështetet në ata pak priftin me në krye Mons. Oroshin dhe, besa, edhe fretënt. Uli kryet para këtyne meshtarëve për punën e tyre që kishin e kanë të bájne me një element shqiptar tepër të vështirë! Ndonjeni prej tyre humbi dhe jetën, si Dom Lazri, disa tjerë ... nervat! Nëse ka pasë mosmarrveshje mes tyre, kjo nuk asht gjë e re, shih dokumentat e Propagandës qysh prej 1600. Tue kthye te sotja, jam i bindun se edhe në vrasjen e Dom Lazrit ka gisht SIGURIMI! Po qes një shembull fort sistematik:

Mbas ndalimit të fesë (1967) e përmes kushtetutës me 1976, fill mbas shpalljes, prof. Koliqi e Valentini organizuen një protestë me shkrim që iu përcuell Vatikanit. Në emën të intelektualëve shqiptarë në emigrim ky dokument u nënshkruar prej një numri të vogël, ndër ta dhe emni im. Mbas dy muesej

isha në Kalabri për gjurmime gjuhësore ndër arbreshë. Një arbresh që vinte nga Tirana, më tha se unë kisha nënshkruar një dokument të tillë se në Tiranë thuhej se do të ndeshkoheshin të gjithë nënshkruerit. Nota bene! Ishte caktue që këtij dokumenti mos t'i jepej publikim sepse ishte friga e përndjekjes së familjarëve në Shqipni. Si u dit kjo punë? Thuhej ndonji papas arbresh ... kush dreqi e di! Unë s' due t'i shgarkohem askuj.

Ata që kanë vuejtë si Krishti në kryq në Shqipni për një gjysë shekulli kanë të drejtë të ankoen. Shtypi e mergimit e ka vu në dukje këtë martirizim sidomos të klerit katolik, por jo në mënyrë të organizueme si polakët, ungarezët etj. Për këta të fundit Vatikanit vetë angazhohej më tepër. Puna e organizueme në këtë drejtim i duhet njoftë një personi që ashtë Gjon Sinishta!

Aktiviteti i secilit nesh u mëvar prej kushteve ku ishim të integruem në punën tonë. Gjoni gjeti në Kaliforni kushtet e përshtatuna, por binte me vete edhe vullnetin e fortë që iu bë obsesion dhe një përvojë gazetareske apo publicistike. Krejt materiali i botuem në San Francisco, në anglisht u bë mbështetje kryesore informimi mbi vuejtet e klerit në Shqipni. U zbuluen edhe arkivet sidomos ai optik, fotografi që fliutshin vetë. Këtë lëndë e shpërndamë edhe ndër universitete dhe në korrespondencë me njerëz të gazetarisë, si ashtë Viktor Maier, korrespondent i Frankfurter Allgemeine

që në këto dit gjindet në Shqipni. Me Dr. Maier jam në kontakt tash 15 vjet. Si albanolog e antar i një universiteti me kohë bähesh qendër informimi për gjithçka i përket Shqipnisë: nuk asht nevoja të dalish me pllakata rrugash. Kështu asht në Evropën Qendrore: stalinistat thoshin se çdo profesor universiteti, tue fillue prej atomistave deri te historianët apo filologët për gjuhë e kulturë të vendeve komuniste qenkan spiunë. Spiunë sigurisht, jo, por, eksperita, po. Krejt programin e ministerepresidentit të Bavarisë në lidhje me të dy vizitat në Shqipni kanë qenë të përgatituna prej zyrtarësh që kanë studiuë albanologji tek unë. Para udhëtimit të dytë jam takue edhe unë me Straus (të lutem, Gjon, kjo imtësi t'i transmetohet edhe Dom Simonit!) ku i jam lutë me duer të ngjituna që të intervenojmë për



Ernest Koliqi

klerin katolik shqiptar dhe të vëhej si kusht në traktatet për vumjen e marrëdhajeve diplomatike. Më parë isha shprehë kundër këtyne marrëdhajeve, si këshilltar, natyrisht. Ndonji prej absolventave të mij në albanologji, Gjoni e di, se ka dhanë kontributit të dukshëm në këtë drejtim, Bernard Tönnies.

Nuk asht e vërtetë se nuk jam shprehë botnisht. Para 20 ditësh kam marrë pjesë në një talk-show (Club 2, ORF i Vjenës) mbi Shqipinë ku merrshin pjesë ambasadori shqiptar, Engel Kolaneci, dhe dy përfaqes të Opozitës (Genc Pollo e Dr. Ardian Klosi), si dhe gazetarë në zë austriakë. Ndër të tjera, në një shamatë me Kolanecin vuna në dukje edhe trajtimin kundrejt klerit katolik në Shqipni tue thanë se edhe sot nga regjimi mbahen jo si qytetarë, po njerëz "të klasës pa të drejta civile, dmth të dekluar". gjë që e pohoi dhe Klosi. Aty ra fjala që libri i Sinishtës duhet të botohet sa më parë shqip, në Tiranë. Këtë talk-show e kanë ndigjuë mijlona ...

Në kushtet e mija e kam krye detyrën time kundrejt klerit tonë që na ka edukue dhe bënë njerëz të cilit i falnderoj dhe pozitën e dijen që kam sot! Po due me thanë, unë e kam krye detyrën time.

Si thashë, rrethanat në të cilat jetuem kanë përcaktue dhe rrugën tonë. Mbrenda këtyne kushteve, natyrisht, kam mbrojtë gjithnjë individualitetin tim intelektual e sidomos si letrar. Si i tillë kam pasë të çame kreje prej intrigantave të Tiranës, por nga ana tjetër nuk kam qenë i përfillun as nga kosovarët, bile as prej shumicës emigracionit. Ti Gjon, i di këto punë ndoshta më mirë se unë. Por kjo s'ka prishë punë në rrjedhën e krijimtarisë letrare time sepse zëja e letrarit asht gjë individuale. Edhe Prof. Koliqi, qesh e nesh, më gucte tue u thanë tjerëve: Martini s'asht atdhetar në poezinë tije. Gjon Sinishta një herë më tha: ti nuk e përmend emnin e Zotit në poezinë tande. Nuk të kam kundërshtue, por kam ra në mendim. Kam pasë disa periudha krijimi; sidomos mbas 1967 kur nis periudha abstrakte apo ajo më e kapërthymja: fund e maje vepra ime ka Provaninë e Perendisë mbrendë. Palimpsest, shkruë në dy vjetet e fundit, sos me tematikë mistike. Tash jam në fund të jetës e báj plane vetëm mujore. Jam fare i qetë.

Për botën shqiptare fillon periudha e re. Për Dom Simon Jubanin e Gjon Sinishtën fillon gjithashtu një jetë me përgjegjësi të madhe. Ato të tri komponente të traditës shpirtore (a, b, c) duhen koordinuë simbas kohës se re, një ndër të ajo nën b) (lamia e veprimtarisë sime përmbi 40 vjet) duhet të bëhet pronë e gjithë kombit. Këtë dishron edhe gjenerata re intelektuale me të cilën kam konferue në kohë e fundit: qysh tash gëzohem për këtë gjë!

Për shumë Mot Pashkët e bafshit ditën e mirë atje ku jam!
Martin Camaj

Vëzhgim redaksional: Në botim i kemi qëndruar besnikë rripodhimt të tekstit origjinal në dorëshkrim. Ndonji sqarim si ndërhyrje e rallë e natyrës redaksionale është parashikuar me kilapa katrone nga botuesi.

P

POEMA

Nga Faslli Haliti

Brenda vetes
Kam tritol inati
Kam dinamit inati gri,
Inati im ka inat të egër tigri...
Ç'farë inati ke kështu inati im?

Tritolin e inatit e çova në gurore për shpërthim.

Brenda vetes
Kam amebën e smirës,
Me gjemba që shpon shpirtra,
Smira ime
Uthulla,
Acidi
Që gërryen dhe ha enën e kuqe të zemrës.
U shpua zemra ime, kupa e bakërt.
Plasën venat, kapilarët periferikë.
Gjaku mori trupin.
Nuk qarkullon,
Derdhet
Nën lëkurë.
Se ushqen më trurin,
Përmyt...
Truri
I përmytur
Prodhon figura çudane.
Lemerit figurash gaforre,
Konfiguracione shtrembëse.

Tru!
Eja në vete
Ç'bën kështu?
S'ta duroj deformimin e figurës së prindërve.
Pse ma deformon, ma bën hardhucë nënën?
Pse ma bën dinozaur babanë?

Tru!
T'i hodha trutë në erë!
Ç'bën kështu?

Sy të shqyer,
Të zgurdulluar, sferikë.
Rokullisen sytë,
Kokërdhokët.
Sy që rrotullohen si sy kameleonësh,
Si sy kameleonësh që shohin para
Mbrapa.
Hundë
Të zmadhuara,
Shtrembëse
Hundë të zvogëluara.

Pinoku
Me hundë fasule,
Sokrati me hundë Pinoku,
Pinoku filozofon shkurt,
Sokrati spiritoz në aeropag,
Ofelia
Me mjekër bionde.
Otello bën dashuri të deformuar me Ofelinë,
Hamleti puth me buzë të deformuara arapi
Desdemonën,
Shelgu i zi
Dridhet nën ujin e gjelbër të pellgut,
Si një Otello gjithë xheloz.

Hamleti
Pusht filozof.
Hamleti, Don Zhuan,
Teatral, marrok...
Otello
Xheloz?
Xheloz nuk vret, nuk mbyl...
Xheloz pret rivalin të vdesë,
Otello
Faqeziu, xheloz, i pabesë !

Puthu Desdemonë!
S'bën pabesi,
Nuk aventuron.
Ti bën dashuri,
Dashuron.

Puthu Desdemonën nën shelgun e zi kësaj
mbrëmje!
Marrëzi e shtirur, fiktive, hamletiane!

Autori vjen në ditëlindjen e tij të 83-të me një poemë, ndërsa kemi menduar që t'ia ruajmë një krijim tjetër për numrat në vijim. Autori shkon drejt një poeme filozofike dhe qëllimi mbetet gjithnjë një sintezë e jetës sonë për botën që e rrethon...Autori apelon përmes poezisë së tij, por edhe mundon të shfryjë për të gjithë padrejtësitë që janë kthyer në normalitet në jetën tonë...

ÇARTJE



Otello
Trajgik
Në xheloz
Puthu Desdemonë!
Puthu, ti puthu, Ofeli!

Tru
Të derdhur,
Si vezë bretkosash plot larva të zeza,
Që pluskojnë në ujërat pranverore.
Vezë laraskash
Në tru.
I dëgjoni çukitjet?
Apo s'i dëgjoni, ju ?

Zogu laraman i laraskës sjepon lëvozhgat në tru.

Tru!
Qenke pa tru!
Krisi korja e hemisferave,
Po të futet marrëzia nëpër krisat, të çarat kështu?

Qelqi i syrit plot arabeska.

Gjak!
Ti s'passe gjak!
Pushoje përmytjen e trurit.
Ushqeje, të paktën, trurin pak...
Mençuria fishket.
Thahet
Pa ty zoti gjak...!

Po ti mençuri, ku e ke mençurinë?

S'ka mençuri
Pa tru,
Nga celulat e trurit vërshuan larva bretkosash.
Kuaqje në trurin e bërë pellg, kënetë..
Kor zarigogash në fluturim,
Përfytyrime çudane.
Shtrembëse,
Si kulla e Pizës
Imazhesh si gaforre,
Mençurira idiote, gallofe...

Kush e ka fajin?
Zemra e shpuar?
Kush të shpoi
Ty,
Zemër ?
Inati im i sertë?
E kuptova...
E shpove ti,
Smira ime uthull, acid?
Pa zemër paske qenë, moj smirë, e zezë, zi!

Unë

Strehoja urrejtje dhe smirë?
Veçja ime
Strehonte çaste urrejtjesh,
Bankete inatesh dhe smire?!
Qenke krijuese mizorish, moj. veçja ime?
Qenkan një zero atëherë dhe unë.

Zero
Me bisht!
Ku e ka bishtin zeroja?
Ç'u bë?
Ja prenë
Apo ia fshehën tinëzisht?

Kurse
Ti
Njësh,
Je biznesmen, je bos.
Duke qëndruar para zerove
Ti bën me to miliona, miliarda..., bën një kaos...

Çudira zerosh!
Zerot
Bëjnë çudira,
Zerot ndërtojnë vila,
Vila
Për 1,
Për 2, 3 ...
Njëshi-
Bosi
Çifciu
Më i madh,
Dyshi, treshi, katra, pesa...
Bosët, çifçinjët më të vegjël,
Vrapues që ia marrin cilido atleti në kthesa...

Për njëshin,
Për dyshin,
Për treshin...,
Parajsa - një shkretëtirë, një Saharë.
Diku. gjetkë, kullosin, harbojnë ata...
I bien Botës kryq e tërthor.
Udhëtojnë
Mbi kurrize zerosh,
Siç e kanë zakon të na cilësojnë,
Domethënë mbi kurrize tona,
Mbi kurrizet e taksapaguesve, domethënë,
Në tavolina Zeuzësh ambrozion shijojnë...

Ne "zerot" mbushim tavolinat e Zeusit
Me të gjitha të mirat e kësaj toke !
Për vete hamë thërrimet,
Lëpjmë kokcat,
Hamë mbeturinat
E kësaj
Bote ...

«Ju zerot, skelet!,
Ju zerot-

Kockë e lëkurë ?
Propagandë komuniste!
Sot, zerot më rrumbullake se kurrë...!»

Ekipi i 1, 2, 3,
Luan bilardo,
Bixhoz,
Luan me zare
Nëpër kazino vendi,
Kazino ballkanike,
Europiane
Zerot duartrokasin.
Njëshi ka shumë klakerë,
Ka tifozëri të madhe.
Të tjerët pak tifozë dhe shumë klakerë.
Sa harxhon klani i 1, 2, 3...?
Më shumë se bunkerët,
Më shumë se tunelet?
Sa harxhojnë "zerot" së bashku,
Sa kanë harxhuar bunkerët?
Brenda meje
Indinjata,
Urrëjtja, protesta, përgjojnë në pritë,
Rinë në pozicion ofensive, beteje...

Urre,
Urre,
Urre, urrejtja ime e urryer!
Protesto,
Protesto
Protesta ime pa pikë proteste!

S'po më ndahesh nga gjoksi moj urrejtje.
S'e kupton vërtet që unë s'të dua?
Unë plaku
Ti rinohu...

Më urrejnë dhe mua!

Zelli im po kalbet,
Vullneti im po bëhet skelet,
Shpatullat po dembelosen çdo ditë,
Duart e mia të thara,
Përtace,
S'po lajnë dot njëra-tjetrën,
Pa le pastaj të lajnë fytyrën.
Dembelia
Placentë urrejtjeje, smire, zillie, inati.

U prishe vullneti im...

Vullnet pa vullnet,
Vullnet pleh,
Me kë t'i kapërcej pengesat?
Ku t'i gjej përpjekjet volitive?
Karakter!
Unë
Mburrem me ty,
Pse tregohesh pa karakter
Vullneti im,
Unë mburresha me ty.
Më dole pa vullnet
Dhe ti.

Mençuri marroke,
Budallaqë mençuri.
Po të flak nga deriça e trurit dhe ty.

Plasën sytë.
S'i shoh hardhucat,
Akrepat,
Gaforret e përfytyrimeve në sy.
Uji qelqor i syve u derdh.
Përmyti mjedisin:
Sferat e syve u rrokullisën.
Drita e syve doli si rufe sferike nga sytë.
Rrufeja sferike e syve zgjon.
Nuk vret,
Përkëdhel,
Nuk trondit.

Mbete
Vetëm,
Zonja inteligjencë.
Të humbi mençuria.
Erudicioni,
Kultura.
Nisi stina e vjeshtës.
Kultura, erudicioni, mençuria-
Gjethet të verdha vjeshtë,
Shkundur nga stuhia.

E ETYD

Autori i kushton një etyd artistit shqiptar nga Mali i Zi, Gjëlosh Gjokaj, duke i përcjellë shumë ngrohtësi dhe respekt...

Porosi malesh: Ai nuk do vdesë kurrë!

(Botohet me rastin e dyvjetorit të vdekjes së piktorit dhe njeriut të mirë)

NGA BAJRAM SEFAJ

Jo vetëm Milesi, por gjithë fshatrat e Malësisë ("Tuzi ndodhet në veriperëndim të Liqenit të Shkodrës, 10 km nga Podgorica, dhe 130 km nga Tirana. Komuna urbane e Tuzit përfshin fshatrat Arrëz, Bardhaj, Bënkaj, Budëz, Camaj, Cemë, Delaj, Dinosha, Dresha, Gurreci, Helmnicë, Koja, Kodërbudani, Ksheva, Llofka, Lekaj, Milesi i Ulët, Muzheçku, Nabomi, Nënhelmi, Nikmarrashi, Omerbozhaj, Pankali, Pikala, Prifti, Rudina, Selishta, Skorraqi, Spija, Stjepohu, Sukruqi, Shipçaniku, Shtëpia e Rakiqëve, Traboini, Trieshi, Tuzi, Vlana, Vrana", por, sikur edhe fushat e gjëra, malet e larta, kodra e kodrina..., sikur gur e dru bashkë me liqenin e Shkodrës vetë..., në ditën e parë të këtij muaji (1 tetor), e lanë një porosi: të shënohet ndonjë fjalë me shumë për një nga këto fshatra, pikërisht për fshatin Milesi të Tuzit. Pse pikërisht për këtë fshat e jo për ndonjë tjetër, kur të gjithë si një kanë emta të bukura me nga një simfoni shkrepash, brenda tyre. (Shqiptojto emrat edhe një herë e provo t'i mbash në mendë, kushtojto nga një poezi, këndoju një këngë!).



Gjëlosh Gjokaj



mbase, shumë shpejtë, do të shpallet thesari i trashëgimisë sonë shpirtërore e kulturore, ose një pjesë e atij, thesari të ruhet në shtëpinë e të ndjerit në Milesi, që ndoshta shumë shpejt edhe do të shpallet Shtëpi Muze. Pse jo!

Milesi i vocërr i Malësisë së Madhe, atë ditë të bukur vjeshte plotë ngjyra (si të huazuara nga mijëra e mijëra pëlhura (telajo) të Gjëloshit tonë), për një çast ishte qendër e madhe të botës së madhe shpirtërore dhe artistike shqiptare, ishte luginë lotësh, ishte pistë mode e veshjes me të zeza, burra e gra, malësorë e malësore vendas dhe nga të gjitha trevat e tjera shqiptare...

Ditë e pikëllimit të madh, na bashkoi! Të gjithë, si një, pjesëmarrësit në çastin e ndarjes prej Gjëloshit tonë, nxituan të hedhin nga një grusht dhe mbi çatinë e tij të amshueshme. Kjo ishte përshëndetja, lamtumira e fundit, me Gjëloshin tonë, atje, në atë Milesi. Bashkë me Ganiun (Gashin), piktor, student i dikurshëm dhe mik i dashur dhe i përjetshëm, (mik shtëpie) i të ndjerit, me pikëllim të madh, për të dytën herë përbirohem sot nëpër kufirin ndër-shqiptar; Hani i Hotit dhe Morinë... Për të satën herë shiu jam pelinin e hidhur e psherëtitë. deri kur me?! malkuor qofsh ore kufij që na ndanë gjithnjë... Rruqa është e gjatë, pikëllimi është i madh. Ani, kemi kohë që Gani Gashi, të shpalo disa, vetëm një pjesë të atyre përjetimeve më të thella gjatë shekullit të shqërrimit me të pa vdekshim kurrë, Gjëloshin tonë, modest e gjeni tok...

dheun e tokës mëmëdhe të lindjes... Toka (dheu) i lehtë i goftit! Ndonëse ishte ditë e lame me një diell të kuqërremët të vjeshtës së parë në Milesi, egjithatë, ajo ishte ditë zie e pikëllimi, jo vetëm për këtë katund Malësie, por ishte ditë dhimbje e krenarie, për mbarë botën e madhe, për të gjithë shqiptarët, kudo e ngado, qofshin ata: atë ditë të shtunë, një tetor 2016, botës tjetër, asaj të ftohtës, të errëtës, të përjetshmes, ia falnim dhe ia lenim amanet dheut të qetë të njeriut tonë të urtë e fisnik,

të gjenit tonë të arteve pamore, të Picassos se maleve tona, një fyell ndër male... sikurse ishte Gjëlosh Gjokaj. T o k ë s , dheut të shenjtë të Mëmëdheut ia dhamë trupin e gjenit tonë që të na e ruaj me xheloz, por, në anën tjetër, as tokës (dheut), as akujt tjetër, nuk ia dhuruar veprën e tij të madhe artistike. Vepra(t) e tij, do t'i ruajnë fondet e galerive të famshme kudo (në)për botë, do t'i ruajnë koleksionistët e pasionuar ngado qofshin ata, e, ata janë të shumtë... Vepra kolosale e Gjëloshit, që,

E para u këput gjethja e mençurisë,
Ra në moçal si këmbë pate;
E dyta ra gjethja e kulturës,
Noton në pellg me rosat;
E treta u këput gjethja eruditë.
Ra në llucë.
Mbeti
Trungu im
Me degë të zhveshura.
Era dredh degët me forcë.

Degët dredhin trungun gjer në tokë.

Trungu im plot miza.
Mizat hanë kalbësirën trungore.
Po përparon kalbësira...
Rrufetë frikësojnë frikën.
Vetëtimat i përcëllojnë vetullat trimërisë .
Trimëria me vetulla të përcëlluara ikën dhe ikën.

Trimëri
Futi krahnun frikës.
Jepti dorën!
Vetëtimë bandite me shtiza flake.
Rrugë kriminale me krisma:
Rruferat pa humanizëm, kulturë.
Vetëtimat injorante!
Përvëloni majat e lisave.
Kurseni shkurret dhe kaçubet me përkulje galante.

Bubulloni bubullima budallaqe,
Servile të vetëtimave!
Stuhira
Me flokët gaforre.
Dallgë
Në panik!
Sulmojnë
Apo ikin të thyera
Dallgët me vrap?
Në shekuj ato sulmojnë brigjet,

Dhe brenda brigjeve mbeten prapë?

Po ai shkëmb pse qan?

Është Niobeja që qan?
Le të pëlcasë së qari mburravecja!
Sfidohet perëndesha Latonë?
Ç'iu desh Niobesë të sfidonte perëndeshën.
Humbi fëmijët sfidantja mitike për pak sfidë.
Edhe ti perëndesha Latonë,
Nerone paske qenë...
Vriten gjashtë vajza.
Vriten shtatë djem?

Edhe vajzën që i le gjallë qyqes Niobe
Dyllë të verdhë ia le,
Frika që i kalle asaj,
E zverdhi
Atë...

Brenda meje,
Dashuria.
Një Dashuri e padashur me mua.
Si s'më deshe,
Si s'më dashurove moj dashuri!
U shtirë ti me mua
Apo unë
U shtirë me ty?

S'të kam dashur unë?
Po më akuzon?
Duan më mirë
Më mirë dashuromë
Dashuromë moj e dashur dashuri,
dashuromë!

Ju veshët e mi pa timpan jeni kësthu,
I dëgjoni apo s' dëgjoni
Gjëmimet,
Bubullimat?
Ju sy
Pa bebëza jeni,

Ç' bëhet rreth e rrotull
Shikoni apo nuk shikoni?
Ju dhëmbë pa nerva, ju pret nxirja!
Si, s' më besoni?

Gjuha shkretëtirë, me kokriza rëre.
Me fjalë të zhuritura,
Të thata
Si rërë Sahare!

Fjalë lakurique mbi rërën e gjuhës,
Mendimet kërrusen në tru.
Ka mendime pa fjalë?
Pyet memecët!
M'u tha gjuha për një syth fjale,
M'u tha fjala për një lule mendimi,
M'u thanë mendimet për idera të reja
Idetë
I mori uria
Për pak filozofi.
Mjerë memecët:
Kanë etje,
Kanë uri
Për një fjalë...
Ej, memecëria ime, memecëri!

Po filozofia
Pse më duhet?
Hahet si buka?
Pihet si uji?
I merret erë si lules,
Vishet si xhakëtë,
Si pallto në stinë dimërore?
Mbathet si këpucët?
Vishet si shall
Në kohëra
Dëbore,
Mbjell, korr, shin, gatuan, ajo vallë?

Filozofia
Një
Xhungël.

Më trembin tigrat, luanët,
Më helmojnë kobrat,
Më tallin majmunët,
Më përqeshin papagajtë:
Më gjerin macet e egra e xhunglës së saj.
Brenda vetes
Kam
Jete
Dhe
Vdekje.

Pa jetë s'ka vdekje...
Vdekja
Është
Skifteri,
Ujku, luani.
Jeta është zogu, kaprollja, fazani, dreri...!

Ka
Zogj
Pa skifter?
Ka skifterë pa zogj?
Ka drerë pa luanë?
Ka luanë pa drerë?
Flaka
I duhet drurit,
Apo druri, flakës?
Shuhet
Flaka
Apo digjet druri?

Po zjarrin kush na e solli, kush na e pruri?

Kur s'ka korrent,
Na rri varur xixëllonja si llambë vajguri,
Kur jeta bëhet e përjetshme.
Vdekja
Bëhet e vdekshme.

Lamtumirë moj vdekje e vdekshme!
Përshëndetje ty jetë e përjetshme...!

E

ESE

"Fytyrë e dyshimtë" është titulli i një drame të Branislav Nushiçit, por autori e ka sjellë për të përcjellë përfytyrimin e tij për botën e sotme ku jetojmë dhe sintezën e tij tejet interesante për vlerën e vërtetë të gjërave...

NGA MILJENKO JERGOVIÇ*

Gjendem në Zyrih për dy ditë. Është hera e gjashtë apo e shtatë që gjendem në këtë qytet. Rrugët e tij mund të them se i njoh në njëfarë mënyre, dhe automatikisht më kujtohet kompjuteri në hotelin Kindli, në të cilin nuk më duhet të hedh që nga fillimi të dhënat e mia- nga të cilat më e rëndësishmja data e lindjes: përse xhanëm qenka e rëndësishme për ata kur dhe ku kam lindur? e di mirë se ku janë dyqanet që më interesojnë më shumë: konfeksionet për zotërinjtë konservatorë, anti-kuariate me orendi dhe vogëlsira të përditshme të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillimit të atij të njëzetë, dhe, natyrisht, dyqanet e panumërta të shitjes së orëve. Me thënë të drejtën në Zyrih pothuajse nuk kam blerë kurrë asgjë, por nuk ka ndonjë qytete tjetër, dyqanet dhe vitrinat e të cilit t'i dua kaq shumë dhe të mos i përjetoj si të mijat. Sikur të mos ekzistonin dyqanet dhe vitrinat e Zyrihut, sot do të besoja se bota ime nuk ekziston më. Natyrisht, me botë kësaj herë nënkuptoj atë që nënkupton shumica, konsumin dhe kapitalizmin e njerëzimit të marrësor pas tij: të mira materiale, gjëra, pajisje me të cilat jetohej dhe pranë të cilave jetohej.

Por identifikimi me botën e vitrinave të Zyrihut është vetëm simbolik. Ata gjëra që gjenden në këto vitrina janë dramatikisht të shtrenjta saqë kaheerë është eliminuar çdo mundësi që dikur unë të kem mundësi të blej ndonjë gjë. E them këtë pa kurrfarë pikëllimi apo keqardhje. Përsa më përket mua, jam i kënaqur tashmë edhe me ato që mund të shoh, dhe që duke i parë marr vesh që ekziston një botë që më përket mua në kuptimin shpirtëror. (Kurrësi mos mendoni se fjalë „shpirtëror“ është përdorur këtu në mënyrë të pakujdesshme).

Gjyshi im, për të cilin shkruaj kaq shpesh saqë ka kohë që ai është bërë fakt letrar, ka qenë nëpunës në hekurudha, kishte grua dhe tre fëmijë, dhe i përkiste shtresës së mesme të atëhershme. Mund të them se në kuptimin klasor ishte njëlloj siç jam unë sot. Në kuptimin praktik kjo do të thoshte: jetonte thjeshtë, por gjithsesi më lart se mesatarja e atëhershme qytetare, sepse kishte mundësi të kishte dy palë kostume të qepura nga stofi më i mirë, pallto dimri prej stofi të trashë, dy palë këpucë, dimërore dhe verore të punuara me dorë të këpucari më i mirë i qytetit, stilograf dhe sahat. Kostumet bliheshin për të një herë në dhjetë vite- me të njëjtin ritëm sikurse sot në botën time blihet veturë e re- pesë vitet e para, kostumi ishte i ri, vishej në ndonjë ceremoni të veçantë, ndër të cilat rregullisht bënte pjesë edhe dita e shtatë e javës, e diela; në mënyrë që pesë vitet pasuese ky kostum bëhej i vjetër dhe vishej përditë.

Gjatë tërë stazhit të tij të punës, pothuajse tërë jetën pra, gjyshi im pati gjithsej katër palë kostume të rinj dhe dy pallto të trasha. Stilograf pati vetëm një, për të cilin një herë në çdo dhjetë vite porosiste pendë të re prej ari në Zyrih, si edhe një sahat të vetëm. Ishte nëpunës hekurudhash, dhe këtë sahat pati mundësi të merrte nga shteti: sahat xhepi markë Zenith hekurudhash, i cili ishte importuar nga Zvicra në vitet tridhjetë nga Hekurudhat shtetërore të Jugosllavisë në një sasi prej disa mijëra ekzemplarë.



Miljenko Jergović

Fytyrë e dyshimtë

Të jesh i pasur dhe të veshësh vetëm një pallto gjatë gjithë jetës

Një herë në vit, përherë në të njëjtën kohë, herët në vjeshtë, ndoshta në shtator, sahatin e dërgonte të një orëndreqësi për pastrim dhe ndonjë remont të vogël të mundshëm. Pak a shumë, me të njëjtin ritëm bënte edhe pastrimin e stilografit. Dihej edhe për rrobaqepësin që përkujdesej për gjendjen e kostumeve të gjyshit, edhe për pastrimin kimik ku pastroheshin kostumet dhe palltoja e tij. Ideali i gjyshit, i cili ishte gjithashtu edhe ideali i brezit të tij, e për pasojë i tërë një shtresë shoqërore dhe bote, ishte të kishte gjëra që të mund të përdoshin një jetë të tërë. Megjithatë qepte kostume nga stofi më i mirë që mund të gjendej në Jugosllavinë e atëhershme ose edhe nga ai që futej kontrabandë nga Vjena, atij i qante zemra për stofra ako-

ma më të mirë, nga ato që mund të përdoshin tërë jetën dhe të dukeshin si të reja. Nëse do ta kishit pyetur atëherë sesi e parafytyron ai të ardhmen, ai do t'u thoshte se në të ardhmen do të ekzistojë stofra që duken si të rinj edhe pasi i ke përdorur për pesëdhjetë vite të tëra. Nuk i kishite qejf gjërat e vjetruara, të shqyera dhe të rrudhosura, orët e prishura dhe stilografët me pendë të prishur që shkruanin trashë, por gjithsesi ishte singerisht i trishtuar kur disa gjëra i vjetroheshin dhe ishte i detyruar të blinte të reja. Kjo gjë e bënte të pasigurt, dhe mund të them se vetëm në atë kohë ndjehej si i varfër. Ta pasur janë vetëm ata njerëz të cilët kanë kurrë të detyruar të blejnë gjëra të reja.

E atëherë, pak pas vdekjes së tij, e

ai vdiq në vitin 1972, bota u përmbyb dhe u shndërrua. U përmbyb dhe u shndërrua në kapitalizëm, duke u bërë kështu një konsumator lugat. Erdhi koha e gjërave të dizajnuara mirë, por ama jociësore, të cilat mund të ndërrohen me një ritëm gjithnjë e më të shpejtë. Kur blej ndonjë kompjuter të ri- njëherë e një kohë ky ishte Apple Macintosh, Mercedesi i sotëm ndër kompjutera- e kam të qartë se pas dy viteve e shumta tri do të më duhet të blej një të ri. Jo vetëm që modeli i vjetër do të vjetrohesh por do të bëhet edhe i papërdorshëm. E njëjta situatë është edhe me kostumet e stilografët: zgjasin për një kohë të shkurtër, një sezon, e shumta dy, dhe pastaj, pa marrë parasysh modën, prishen.

Kam një sirtar plot me celularë të vjetruar. Ndërmjet atij të parit dhe këtyrë që përdor sot, kanë kaluar më shumë se dymijë vite. Natyrisht këto janë vite subjektive dhe teknologjike, vite që na i sugjeron logjika e botës së konsumit, qëllimi i së cilës është që çdo sezon të bliji një gjë të re dhe akoma më të re. Para pak kohësh bleva përfundimisht një iPhone 7+. Një mikeshë e imja më sugjeroi që të kisha prituri edhe pak derisa të dilte teta. As që u përpoqa t'i shpjegoj asaj se një gjë e tillë as që më intereson dhe se do të isha më i lumtur sikur të kisha mundësi të kisha vetëm një smartfon për tërë jetën.

Nuk kam fort qejf të ndryshoj gjërat e vjetra me të reja, njëlloj sikur nuk deshte as gjyshi im. Në këtë fushë ai ishte fëmijë e epokës së tij, ndërsa unë jam në një epokë të gabuar. Prandaj edhe argëtohem në vitri-



nat e Zyrihut, i cili në një formë disi të ndryshuar, ka ruajtur idealat e epokës së kaluar. Vërtetë këtu mund të bësh gjëra që njeriut mund t'i bëjnë gjatë gjithë jetës. Ndoshta në Zyrih ekzistojnë edhe nga ai lloji im kostumeve që i bëjnë njeriut për gjithë jetën. Ndoshta ekzistojnë edhe kostume të tilla, ndërsa për-sa i përket palltos, këtë e kam parë me sytë e mi. Dhe ajo më e rëndësishmja, për të cilën unë kam një pasion të veçantë: sahatët. Çdo sahat i tillë, nga ata, që shoh është më i fortë dhe më i qëndrueshëm se një jetë e tërë njerëzore. Këto janë sahatë që shënohen në testament dhe përcillen nga një brez në tjetrin. Atë sahatin e gjyshit që e kam trashëguar dhe e kam pas mbajtur gjatë rinisë time, por tani nuk më shkon të mbaj në dorë një sahat hekurudhsh të viteve tridhjetë e kusur. Më duhet të mbaj një sahat civil.

E kështu, në krye të çdo dy apo tri vjetëve, blej një Swatch të ri. Pasi i'a ndërroj baterinë, del se më është vjetruar rripi, sahati vjetrohët me shpejtësi rrufeje dhe, përsëri më shumë në kuptimin simbolik sesa atë praktik, bëhet i papërdorshëm. Kam edhe një sirtar plot e përplot me sahatë dore. Vështirë të thuhet se kush është më i pavlefshmi. Madje kam edhe atë sahatin e vyer, trashëgim nga gjyshi, vlera koleksionuese e të cilit ndoshta nuk është fort e lartë, sepse është pas prodhuar në një numër të madh kopjesh dhe qoftë edhe me një shikim të saktë nuk mund të përcaktohet se cili kampion është i saktë. Gjëja bazë në mirëmbajtjen e sahatit të xhepit është t'a kurdisësh përherë në të njëjtën kohë dhe një herë në vit t'a der-gosh për t'i bërë një pastrim.

Kam pas vendosur që dikur të kem një sahat mekanik, i cili do të më shërbente përjetë dhe me të cilin do të shkoja te orëndregësi, do t'a kurdisja përherë në të njëjtën kohë, të masia me të kohën dhe t'a harmonizoja atë me kohën time. Tani e di mirë se nuk ekziston një diçka e tillë. Është tejet e kushtueshme. Madje e di se edhe për farë sahati bëhet fjalë: Zenith, El Primero Captain. Ose ndonjë nga nëntipat e hershëm të El Primerit. Në vend të tyre ndoshta ka mundësi të blej një Seatch të ri me bateri, dhe të mbush akoma më shumë atë sirtarin tim të sahatëve. Nëse kjo është sakrificë më e madhe që unë u dashka të bëje për hir të çmendurisë së epokës konsumatore, atëherë le të jetë kështu.

Zotëria nga jozotëria dallohen nga ajo se zotëria i vërtetë ka vetëm një stilograf (ndoshta edhe disa të këqij) dhe vetëm një sahat të mirë. Sahati nuk është detaj domo që të ndërrohet sipas ngjyrës së këmishës apo kravatës. Sahati i mirë është ai që shënohet në testament, ose edhe pa testament, por i llihet nipit.

Këto gjëra sjell ndërmend teksa shënis rrugeve të Zyrihut dhe argëtohem singjerisht duke vështruar vitrinat e këtyrë qytetit tejet të pasur, pasuri që gjithësesi e ka absolutisht të merituar. Këtu ndjehet më pak ai terrori i kapitalizmit neoliberal dhe asaj çmendurisë konsumatore, gjithësesi më pak sesa në ato qytete tona ballkanike dhe shopping centrat e tyre, në të cilët njerëzja, të palumtur dhe të rrudhur, blejnë lumturinë e tyre një-sezonale.

I'a vlen të çlirohem nga presioni i të mirave materiale të jetës tonë të vogël dhe njëpërdorimshme. Por, kjo është e mundur vetëm në dy mënyra: ose të bëhemi murgjer, të bashkohemi me aventurierët dhe asketët dhe të mos kemi asgjë, ose të mbajmë pranë vetes ato gjërat më të mira të asaj kohe, gjëra të cilat në mënyrë të pandryshueshme, e ndjekin njeriun gjatë gjithë jetës: stilograf, sahat dhe nëse ekziston ndonjë kostum i tillë dhe pallto. Njeriu bëhet rob i gjërave vetëm atëherë kur i duhet t'i ndryshojë sadopak.

* Publikuar në gazetën "Jutarnji List". Përktheu nga origjinali Xhelal Fejza

A

ARGUMENT

Pesha e mungesës së një Galerie Arti në Tiranë

NGA BEN ANDONI

Prej kohësh në Tiranë ndihet sin qerisht mungesa e një galerie mirëfilli arti. Jo që në Tiranë nuk ka ku ekspozohet, por kufizimi është i tillë, sa që nuk i përgjigjet realisht peshës specifike që ka qyteti ynë. E ndjejnë këtë më shumë komunitetet e artit pamor, që detyrohen të shkurtojnë kohët e ekspozimit apo në rastin më të mirë të ekspozojnë në mjedis të papërshtatshme. Sa për Galerinë e Madhe të Arteve ajo është mbyllur për komunitetin e artit pamor dhe ndër vite ajo ka përfaqësuar interesat vetjake të drejtorëve të saj, diktuar nga politika e Ministrisë së Kulturës. Më thjeshtë: Nëse e kishe dhe e ke mirë me Ministrinë e Kulturës, atëherë të thuhet: Mirësevjen dhe mund të futesh kurdo. Fatkeqësisht, kësaj fryme nuk i shpëtoi dhe drejtori i ri, promovuar si shumë modern nga qarqet zyrtare të Tiranës.

Ka një shqetësim të madh mes artistëve të artit pamor se kjo ndërmarrje gati historike për qytetin tonë, e tillë mund të konsiderohet ngritja e Galerisë, kur nuk u bë në kohën e kryeministrit Edi Rama, nuk do të bëhet as edhe njëherë si duhet. Arsyeja është e thjeshtë: Edi Rama ka qenë vetë piktor, ende merret dhe e promovon veten si të tillë dhe e di nevojën e madhe të ekspozimit për artistët ashtu si e kupton nevojën deri në ulërimë të ndihmës ndaj artit. Në fakt, themi se e kupton pasi ka një lloj sqime, e cila është provuar dhe këtë e ka realizuar me mjedisin e ekspozimit që ka krijuar te COD. Në pak vitet e ekzistencës, paçka fjalëve që janë thënë, ky mjedis ka bërë vend për artistë të njohur, për artistë të huaj, për shfaqje të gjinive të ndryshme dhe më shumë se kaq për kurimin e imazhit artistik të kryeministrit si mecenat kulture. Për hir të së vërtetës, ky imazh, është disi larg me nevojat reale të artistëve, kërkesat dhe mbi të gjitha inkurajimin e tyre. Këtë e ndjen nga tkurrja e madhe e artistëve, nga mllëfi i tejet që kanë dhe mbi të gjitha mungesat reale të sistemit të përkrahjes ose ndihmës. Por më shkoqur: Artistët kryeqytetas realisht nuk kanë se ku të ekspozojnë. Të ekspozosh në galeritë private, duhet thënë se askush nga ato se ka realisht statusin e një institucioni, që përbën respekt.

Duket se konfuzionin e ka shtuar dhe hermetizimi i Galerisë së Arteve, shurdhëria dhe mungesa e komunikimit të drejtorit të ri. Ky i fundit, deri më tani, përbën një nga zhgënjimet më të mëdha të jetës institucionale kulturore për mos shprehjen e tij dhe artikullimin e ideve. Në fakt, mbase i rëndohet kot, sepse nuk ka asnjë ide dhe njerëzit presin të lexojnë memecerinë. E nëse do të jetë e vërtetë dhe ajo që është artikulluar në shtyp se është mbyllur dhe aktiviteti ndërkombëtar "Onufri", atëherë mund të thuhet se ky institucion mund të konsiderohet si i harruar për komunitetin artistik të kryeqytetit dhe më gjerë.

Është vonë, por asnjëherë aq sa projekti i ngritjes së një galerie metropoli të mbetet jashtë vëmendjes në qytetin që pretendon të ngrëjë një impiant olimpiq, që pretendon të bëjë finale të Superkupës në futboll, që do të bëjë koncerte dhe samite të mëdha, por edhe që sëshpejti do të festojë 100-vjetorin si kryeqytet i shqiptarëve. Nuk është kurrë vonë të bësh një galeri, që të jetë streha e artistëve, sepse e tillë ka mbetur puna tani, që atyre thjesht t'u jepet një strehë ku të ekspozojnë...



...

Nuk është se një galeri arti do të bënte diçka ndryshe për kryeqytetin tonë, por ekzistenca e tij do të tregonte realisht sesa mund të investohemi realisht neve në qytetin tonë, një metropol që po i afrohet 1.5 milion banorëve dhe ku arti duhet të përfaqësojë një parametër tjetër në stadin e ri kulturor të banorëve të saj.

Ndër vite është thënë se do të bëhet një galeri e tillë, madje në vitin 2012, pothuaj ishte e ndërtuar dhe u shpall si institucion që do ishte në funksion të jetës artistike të kryeqytetit. Por, mjediset që u krijuan nuk e justifikuan asnjëherë nevojën reale që kryeqyteti ka për një galeri të tillë. Është për të ardhur keq se në të gjithë promovimet e shumta që bën kryebashkaku i ri dhe kryetari i Opozitës Basha para tij, kur ishte qytetari i parë i Tiranës, asnjëherë nuk është menduar realisht ndërtimi i një institucioni të tillë. Ky i fundit kinse precizoi dhe vendin ku do të ndërtohej Galeria e kryeqytetit, që i binte një vend tek pedonalja e sotme. Ca më keq akoma, ndërtimi nuk u arrit dhe në kohën e kryebashkikut Edi Rama, pasi me çfarë kuptohet, realisht asnjë nga

kryetarët nuk e ka vlerësuar komunitetin e artistëve të artit pamor. Ai që do të bëjë diçka për qytetin mbase duhet të jetë një njeri që nuk është i afërt me këtë zhanër sepse rasti i sotëm i qytetit tonë po e tregon më së miri këtë.

Duket se konfuzionin e ka shtuar dhe hermetizimi i Galerisë së Arteve, shurdhëria dhe mungesa e komunikimit të drejtorit të ri. Ky i fundit, deri më tani, përbën një nga zhgënjimet më të mëdha të jetës institucionale kulturore për mos shprehjen e tij dhe artikullimin e ideve. Në fakt, mbase i rëndohet kot, sepse nuk ka asnjë ide dhe njerëzit presin të lexojnë memecerinë.

Tirana ka nevojë të pafundme për një galeri dhe një sistem menaxhimi që të jetë mik me piktorët dhe jo mohues si deri më sot. Që do të thotë vend më shumë për të gjithë brezat, heqjen e indiferencës ndaj shumë artistëve, siç ndodh prej vitesh me "Nëntorin" (që mbledh disa nga piktorët e historisë sonë të pikturës) dhe barazi e mundësi ekspozimi dinjitoz për të rinjtë.

Është vonë, por asnjëherë aqsa ky projekt të mbetet jashtë vëmendjes në qytetin që pretendon të ngrëjë një impiant olimpiq, që pretendon të bëjë finale të Superkupës në futboll, që do të bëjë koncerte dhe samite të mëdha, por edhe që sëshpejti do të festojë 100-vjetorin si kryeqytet i shqiptarëve. Nuk është kurrë vonë të bësh një galeri, që të jetë streha e artistëve, sepse e tillë ka mbetur puna tani, që atyre thjesht t'u jepet një strehë ku të ekspozojnë.

(Milosao)

B

BOTIM

Tirana-mahnia të jep befasinë që çdo tiranas i vërtetë ka për qytetin e vet, por edhe shpirtin e vet të madh, pikërisht atë që i dhuroi siguri dhe ngrohtësi valëve të mëdha të të ardhurave në këtë 100 vjet. Pikërisht, ata që i dhanëtribute të reja fizionomisë së saj. A arritën t'ia kthenin këta të fundit? Kjo mbetet për t'u diskutuar, por qëllimi i koleges sonë ka qenë një dhe i vetëm, për ta bërë sa më të adhurueshme pamjen e qytetit tonë të bukur dhe të përkorë...



TIRANA-MAHНИЯ e Rezarta Delisulës



NGA BEN ANDONI

Duhet të ketë qenë e paimagjinueshme asokohe për gazetaren e re Rezarta Delisula, që do vinte një ditë, njëzetë vite më vonë t'i kushtojë qytetit të saj. Por, jeta, ashtu si të përplas me kapriçot e veta të afron dhe me destinat. Për vite me radhë, përmes rubrikave që krijoi dhe mbi të gjitha mbulimin që i bëri çdo caku dhe pragu të kryeqytetit, ajo tregoi jo thjesht konceptin e saj për qytetin por edhe dashurinë e madhe për vendlindjen e saj. Mbi të gjitha ajo diti të lexoj kumtet që ky qytet përçoi ndër vite për tiranasit përmes shpirtit të madh dhe mbi të gjitha dashurisë humane. Një nga këto mesazhe arriti të lexojë mirëfilli Rezarta, që tashmë nën petkun e gazetares së njohur të sociale dhe redaktore me përvojë, t'i kushtojë qytetit të saj me botimin



të cilët duan t'i gasen kulturalisht kryeqytetit tonë. Delisula, në ndihmë të shtjellimit të këtij libri, ka pasur dhe një sërë shkrimesh, të cilat i ka bërë gjatë viteve dhe më shumë akoma, gjatë përpjekjeve të saj për të zbuluar çdo cep të qytetit.

Përveç informacionit të gjerë në disa fusha, libri të ofron dhe një pamje shumë interesante fotografike të shëndërrimit të



e fundit Tirana-mahnia.

Sfida ishte pak e vështirë, pasi, në këtë udhë kishin ecur dhe shumë syresh para saj, ndaj ajo zgjodhi një formë të këndshme, duke shkruar idenë e një zhanri miks përmes guidës së Tiranës së harruar, gjeografisë, arkitekturës, fotografisë, të drejtës zakonore dhe përshkrimit gati lirik dhe nostalgjik të qytetit tonë. Në ditët, muajt në vijim libri do të tregojë realisht vlerat e tij nga përcjellja që do t'i bëjë publiku dhe kritika, porse që në fillim me prezantimin e tij, gazetarja e njohur tregoi se dashuria e saj për Tiranën e kishte kryer misionin e parë, falë pjesëmarrjes të gjerë.

Tirana-mahnia të jep befasinë që çdo tiranas i vërtetë ka për qytetin e vet por edhe shpirtin e vet të madh, pikërisht atë që i dhuroi siguri dhe ngrohtësi valëve të mëdha të të ardhurave në këtë 100 vjet. Pikërisht, ata që i dhanëtribute të reja fizionomisë së saj. A arritën t'ia kthenin këta të fundit? Kjo mbetet për t'u diskutuar, por qëllimi i koleges sonë ka qenë një dhe i vetëm, për ta bërë sa më të adhurueshme pamjen e qytetit tonë të bukur dhe të përkorë. Libri është dy-gjuhësh (shqip-anglisht) dhe kështu përbën një kontribut të madh për të huajt



këtij qytetit, prej një zone të vogël urbane në një metropol, që duhet thënë se në vitet tona mbart frymën e zhvillimit të vendit.

Kjo e bën librin që të shikohet me respekt, por nga ana tjetër të të mbajë pezull përmes shfletimit të 176 faqeve, mbushur me fakte, argumente, histori dhe fotografi të qytetit tonë të dashur. Nga ana tjetër, përmes titujve shumë goditës, ajo ka goditur me nuhatjen e publicistes së shkathët të kureshtojë në çdo moment.

Libri mban dhe një staf të tërë, dhe kjo e bën të respektuar për punën. Fotot janë bërë nga Endrit Delisula dhe mbulojnë përveç pamjeve panoramike nga gati çdo cep të qytetit dhe detaje interesante. Enxhi Terihati është marrë me sukses me përkthimin, duke i dhënë një karakter të madh njohës edhe për të huajt librin, kurse Afërdita Hysaj dhe Artan Buca janë marrë me layout e librit. Një punë e mirë i dedikohet dhe redaktore së librit Fiorela Katroschi, që e ka sjellë në formatin publik.

Në përfundim mund të thuhet se rruga që nisi gati njëzetë vite më parë ka dhënë dritë shprese të gazetarja, që ia shpërbleu qytetit në vigjilje të 100-vjetorit të pagëzimit si kryeqytet me këtë botim të ri të vyer.

Opinioni *i* Ditës

Pse e trash Rama zërin në Kosovë

Nga Dritan Hila

(vijon nga faqja 1)

... si dikur dhe iniciativat që merren janë më shumë të karakterit propagandistik. Edhe objektivi i roamingut të përbashkët, është më shumë një objekt pune i kompanive celulare sesa i qeverive. Qarkullimi i lirë mbetet siç ka qenë, dhe heqja e kontrollit, nuk është se bën gjësend me vlerë edhe në aspektin e këndvështrimit të kursimit të kohës.

E reja e këtij takimi ishte bashkimi kombëtar brenda vitit 2025, i shpallur nga Rama.

Në fakt, nuk ka ndonjë gjë të re nga ato që deklaroi ai. E ka bërë edhe para katër vjetësh nga një ballkon i Ulqinit, e pastaj si tullumbace kuq e zi në fund të çdo takimi të përbashkët.

Ajo që ka ndryshuar është koinjunktura ndërkombëtare. Në Uashington ka ardhur një ekip i ri, i cili po kërkon të presë sa më shkurt drutë me çështje minore për interesin amerikan. Ndosh-ta në SHBA janë lodhur me dy shtete të dobëta që krijojnë vetëm probleme, kështu që do të donin vetëm një të tillë, që do të thotë një problem më pak.

Një shtet i bashkuar shqiptar është edhe më ekuilibruar në rajon. Pastaj sa proamerikan do të



jetë, mbetet për t'u parë, pasi ne proamerikanizmin e kemi vetëm në letra. Gjithsesi nuk do të jetë prorus.

Një Shqipëri e bashkuar do të jetë një problem më pak për Evropën. Tashmë ajo ka pesë sh-

tete që nuk e njohin Kosovën, dhe gjasat janë që nuk do ta njohin edhe në të ardhmen, jo aq për shkak të punës së diplomacisë serbe sesa problemeve të brendshme të Qipros, Greqisë, Sllovakisë, Rumanisë dhe Span-

jës. Afrimi i orës së pranimit të Serbisë në BE, ngrre edhe problemin shqiptaro-kosovar. Nuk mund ta lenë Shqipërinë jashtë, ashtu sikurse nuk mund të pranojnë Serbinë duke lenë jashtë

viktimën e saj Kosovën.

Ndaj ngjan se një bashkim i Kosovës me Shqipërinë, është nyja gordiane që zgjidhet me një të rënë të shpatës. Gjithë problemet e njohjes apo pranimit të Kosovës, zgjidhen me bashkëngjitjen e saj Shqipërisë, i cili është një vend i njohur ndërkombëtarisht dhe subjekt i së drejtës ndërkombëtare dhe NATO-s.

Por BE heq edhe një telash të madh në perspektivë: Edhe nëse Kosova i fiton gjithë atributet që kërkon madje futet edhe në BE, si i bëhet me funksionimin e këtij subjekti, i cili edhe kështu si është, është mjaft burokratik. I imagjini dy vota shqiptare në BE? Rasti Greqi-Qipro është një dhimbje koke për BE. Nuk ka mangët edhe një shqiptar.

Problemi është nëse do jemi bashkë me Mitrovicën apo jo. Kjo varet tërësisht nga këmbëngulja jonë.

Kjo e shpjegon ndoshta edhe zërin e trashur të Ramës në Pejë, që për pak sa nuk e shau nga nëna Evropën. Në një rast tjetër, kjo sjellje do të ishte bileta për ta çuar fishek e në Surrel, pa të drejtë kthimi në bulevardin 'Dëshmorët e Kombit'. Por sot ngjan se janë ndryshe punët. Gjithsesi nuk do duhet shumë kohë ta mësojmë. Në historinë e një populli, 7 vjet janë veç një dekadë.

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

çdo të shtunë falas me GAZETA SHQIPTARE

BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Dje në "Deutsche Welle"

Jugosllavia: E dashur, e urryer, e shpërbërë

Nga Vokler Wagener

(vijon nga faqja 1)

... marrë rreze dielli në territorin kroat. Tito qeveriste ende, më shumë me aureolën e tij se sa vërtet, e megjithatë - socializmi nën palma të dukej i mrekullueshëm. Tre vite më vonë kam shkuar sërish në vendin e vetëad-ministrimit punëtor. Liria e Jugosllavisë mes perëndimit kapitalist dhe lindjes komuniste (jo vend i angazhuar në bllok) i bënte për vete si të majtët perëndimorë gjermanë, që nuk e donin politikën amerikane kundër Vietnamit, por që dënonin edhe politikën e gulagëve të sovjetikëve. Edhe unë kam qenë një prej tyre.

NJË VEND TJETËR

Padija ime historiko-politike, naiviteti im i çiftëzuar me optimizmin e paarsyetuar rinor edhe pas vdekjes së Titos (1980) vazhduan ta romantizojnë shtetin e puthur ndërkohë nga vdekja. Pse jo? Dukej sikur shumë gjëra funksiononin... Në parajsën e punëtorëve vetë të punësuarit i përcaktonte qëllimet e sipërmarrjes, përfshirë rroga dhe pagesa të tjera. Të luash tenis në kohën e punës apo të kalosh kohën në kafe, - asgjë e tillë nuk përbente problem. Udhëtim me orë të tëra me autobus për në Trieste thjesht për të blerë, të gjitha ishin të përhapura si një sport popullor, edhe pa bërë kërkesë për ditë pushimi në punë mund të largohesh. Relaksim i plot!

Por po kaq i famshëm ishte edhe joproduktiviteti jugosllav: Mesatarisht dy orë e gjysmë punë reale për person. Një rekord negativ në Europë që në vitet 70-të. Motoja e punës - askush nuk mund të pagujë më keq se sa punoj.

SHENJA E KRIZËS - MUNGESA E KAFESË

Nga ana ekonomike Jugosllavia e filloi të tatëpjetën e rënimit ekonomik pas vdekjes së Titos. Udhëtimet në gati vendlindjen time të dytë i ngjasonin lëvizjes me shtëpi: ilaç rrobash, pajisje elektrike (sigurisht pa doganë), e sidomos kafe duhej të merrje me vete. Llojin Minas më së miri, që e gjeje në kufirin austriako-jugosllav në Vurcen ose Loibl.

Mungesa e kafesë është një shenjë krize. Gjithnjë e më shumë po boshatiseshin raftet në supermarketin vendas, "Brodokomerc". Receta e Titos -që si rusët dhe amerikanët të paguanin njësoj për vendin me rëndësi strategjike në pikëlidhjen e blloqeve nuk funksionoi më pas vdekjes së tij. Përfundimisht ky koncept i dorës së mbajtur hapur nga të dyja krahet dështoi më rënien e Perdes së Hekurt. Papritur Jugosllavia humbi të gjithë rëndësinë e saj.



Me rënimin ekonomik filloi edhe lufta për shpërndarjen e burimeve. Kroatët kërkuan t'i merrnin për vete të ardhurat nga turizmi bregdetar dhe refuzuan t'i dërgonin Beogradit transferat financiarë. Sllovenët, shvabët jugosllavë, që prodhonin mikrochip-s që në vitet 70-të në Slloveni menduan po ashtu - pse të bashkëfinancojmë kosovarët e varfër, që ende marrin ujë me kovë nga pusi? Erdhi ora e nacionalistëve. Federata e gjashtë republikave me dy provinca autonome ishte thjesht një fasadë. Papritur filluan të shtroheshin pyetje si - ku jetojnë serbë jashtë Serbisë? A ka kufi historik? A janë myslimanët boshnjakë një komb?

Kombe të vonuara Ushtrime akademike, që sollën fushata urrejtjeje ataviste në vitet 90-të. Ethet e përpjekjeve kombëtare për pavarësi i kushtuan jugosllavëve 160.000 viktima në luftëra të paimagjinueshme brutale. Përpjekjet e britanikëve dhe francezëve sidomos për të shpëtuar Jugosllavinë si një njësi shtetërore ishin iluzore. Njohja që Gjermania u bëri Kroacisë dhe Sllovenisë në vitin 1992 nuk ashpërsoi asgjë që në kuptimin e ruajtjes së shtetit kishte humbur me kohë.

E në fund bombat kundër Serbisë: Shprehja e patëkëq në kuptimin gastronomik në Gjermani, "hajde të shkojmë tek jugosllavi"

mori papritur një kuptim tjetër. E parë në restrospektivë në kujtesë mbeti një mirëqenie relative e Jugosllavisë, kufijtë e hapur dhe diçka si një "nostalgi neurotike", siç shkruan shkrimtari serb, Bora Cosic. Por askush nuk do të kthehet në këtë të shkuar.

Jugosllavia ishte një eksperiment tragjik i historisë. Kombet e vonuara në juglindjen europiane janë fakt. Të marra me gjak, të festuara me entuziazëm, por as himnet dhe as flamujt kombëtar nuk krijojnë vende pune.

Kudo në Kroaci, Serbi apo Bosnje-Hercegovinë të rinjtë largohen nga vendi. Një dramë e pasluftës pas dramës së luftës. Nëse shkoj si pushues mes jugosllavëve ndjej një depresion depërtes në shoqëri. Disa të moshuar papritur kuptojnë vlerën e disa sigurive jetësore në epokën socialiste, të rinjtë i kanë sytë nga Europa. Me gjithë simpatinë për krijimin e shteteve të vonuara të sllavëve jugorë, - shtete që britanikët, francezët, hungarezët i krijuan shekuj më parë... të dhemb të shohësh Jugosllavinë si katastrofë të historisë dhe shtetet pasuese si pacientë në krizë.

Mungesa e kafesë është një shenjë krize. Gjithnjë e më shumë po boshatiseshin raftet në supermarketin vendas, "Brodokomerc". Receta e Titos -që si rusët dhe amerikanët të paguanin njësoj për vendin me rëndësi strategjike në pikëlidhjen e blloqeve nuk funksionoi më pas vdekjes së tij.

HOROSKOPI

DASHI

Mund të takoheni me një person të rëndësishëm sot, që do të ketë shumë interes për ju. Bëni mirë të komunikoni ashtu siç duhet me të gjithë njerëzit që ju rrethojnë. Mos u shqetësoni për çështje materiale, por përpiquni të mendoni vetëm pozitivisht.

DEMI

Nuk do të jetë një ditë ashtu siç ju e dëshironi. Madje në fund të ditës, nuk do të dëshironit të kujtonit asgjë nga ato gjëra që ka ndodhur sot. Mendoni sesi mund t'i ndryshoni disa gjëra që ditët e tjera të mos jenë si kjo e ditë.

BINJAKET

Përqendrohuni më së shumti tek vetja dhe harrojeni reagimet e mundshme të të tjerëve. Mendoni sesi mund të kënaqeni sa më shumë apo në cilat aktivitete argëtuese mund të merrni pjesë. Mos u shqetësoni për ata që u ndërpresin rrugën, pasi është diçka momentale.

GAFORJA

Disa persona të shenjë së gaforres do të dëshirojnë të ndryshojnë look plotësisht. Ka gjasa të realizoni një udhëtim shumë të bukur me njeriun tuaj të zemrës. Në mbrëmje do të mbizotërojnë romanticiteti.

LUANI

Mos u përpuni që ta ktheni të gjithë bisedën rreth vetes suaj. Tregohuni më pak egoist, pasi kështu do t'ju vlerësojnë të tjerët. Gjithashtu, do të vlerësojnë edhe anën tuaj njerëzore nëse hyni dorë nga fjalët e panevojshme.

VIrgJERESHA

Nuk do të mund t'i rezistoni disa blerjeve spontane, por ka gjasa që të dilni jashtë parashikimeve duke shpenzuar më shumë se buxheti juaj. Pjesa tjetër e ditës do të jetë paksa monotone, pasi do të kryeni disa detyra të zakonshme në shtëpi.

PESHORJA

Personat e shenjë së peshores duhet të bëjnë kujdes kur shprehin kritikën e tyre. Ka gjasa që të merrzëni gjatë një bisede me partnerin/partneren tuaj, çfarë mund t'ju prishë kënaqësinë e ditës së diel. Megjithatë, gjithçka do kalojë në këtë aspekt në ditët në vijim.

AKREPI

Sot do të përfitonit vetëm nëse shmangni një konflikt. Përpuni ta jetoni jetën sikur keni përmbyshur gjithçka. Nëse nuk shqetësoheni për çështje të kota, atëherë do të mund të relaksoheni. Shmangni personat që ju afrohen për interes.

SHIGJETARI

Do të tregoheni shumë të kujdesshëm kur të takoni disa persona me të cilët nuk keni komunikuar më parë. Ka gjasa të realizoni një marrëveshje të rëndësishme financiare, e cila do të mund t'ju sjellë shumë të ardhura.

BRICJAPI

Pjesa më e madhe e personave të shenjë së Bricjapi nuk do t'ju duhet të nguten për të zbatuar gjithçka njëkohësisht. Ka gjasa që familjarët dhe disa miq t'ju ndihmojnë. Ndiq intuitën, dhe mos nguroni të veproni. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita juaj me fat.


UJORI

Ujori mund të përdorë këtë ditë për të ndihmuar në lehtësimin e barrës së problemeve të pazgjidhura. Nëse shqetësoheni për disa gjëra që nuk varen prej jush, kjo thjesht do t'ju shtojë stresin. Shfrytëzoni çdo shans që iu del përpara.

PESHQIT

E diela do të jetë plot aktivitete për ju. Megjithatë, do të fokusoheni vetëm në një çështje të rëndësishme. Disa persona të kësaj shenje mund të vendosin të bëjnë disa ndryshime në jetën e tyre personale, ndërsa disa të tjerë do të përqendrohen në sferën financiare.

Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL**
 2. Janë rivalë.
 12. Kurosawa, regjisori i Rashomon
 14. Janë fushat sportive.
 15. Memoria në computer
 16. Inicialet e Konicës.
 18. Halili këngëtare
 19. I famshmi Pacino.
 20. Ishin kalorësit e Karlit të Madh
 23. Fundet pa fund.
 24. Eshhtë shenjë goditjesh.
 26. Giberna në MotoGP.
 28. Janë kulla në xhami.
 29. Ente Tregtare Durrës.
 30. Janë temperaturat më të ulëta.
 31. Christian i modës
 33. Pak anakronike.
 34. Erwin që thirrje Dhepra e shkretëtirës.
 36. Eshhtë garë sipërmarrësish.
 39. Në fillim të verës
 40. Diego pa çifte.

42. Të fundit në tender.
 43. Mund të jenë kuzhine.
 45. Mbyllin një krah
 46. Merret nga ai që çan ferrën.
 49. Kufij itinerari.
 50. Një... italiane.
 51. Një treshe në skenë.
 52. Ka ndodhur.

VERTIKAL

1. Jessica Parker aktore.
 2. Basinger aktore.
 3. Mbetur në fund.
 4. Fillojnë nazet.
 5. Të parat në stadium.
 6. Parashtesë për gjysmë.
 7. Një mund të jetë ekspres
 8. Janë ndalime në pranga.
 9. Marina këngëtare italiane.
 10. Mund të jetë autonome.
 11. Një sallë për drama.
 13. Eshhtë laps.
 16. Eshhtë bota e luleve
 17. Trëndafili i Japonisë.
 20. Një bukë që hahej me qofte.
 21. Janë kapo kozakë.
 22. Ndryshon një çdo ditë.
 25. Punon në galeri.
 27. Emri tjetër i Esaut.
 29. Emri i dikurshëm i Tokyo-s
 30. Një mund të jetë arkëtimi.
 32. Një vrap pele.
 34. Kujtohet ne nostalgji në pleqëri.
 35. Franz kompozitor
 37. Një lumë i yni.
 38. Mbarojnë fare.
 41. Qerre pa qe.
 44. Ente Industriale Rajonale.
 47. Qendër në kaos.
 48. Inicialet e Gide.
 50. Diftong në dual.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. U shpik nga Volta.
 5. Janë si kasolle
 11. Negri ppete italiane.
 12. Mund të jenë edhe plehrash.
 14. Fillojnë raportin
 15. Mbarojnë kurse
 16. Emër djali.
 17. Sharif aktor.
 19. Ai dhe ajo.
 21. U verbua nga Askush
 24. Kanë mbetur në klasë.
 26. Ishite djali tjetër i Odiseut.
 27. Topat pa kufij.
 29. Janë edhe ato ultraviolet.
 30. Në krye të noterëve.
 31. Një Baba përrallor.
 32. Rrota pa ekstreme.
 34. Mund të jetë diesel.

VERTIKAL


37. Ashtu qoftë... o hoxhë!
 38. Lidh computerin me telefonin një i tillë.
 40. Një pjesë e gastritit.
 41. Lumi i i Bernës.
 43. Janë pikat në statut.
 44. Janë çift në gjethe.
 46. Mc... shigjeta e argjendtë.
 48. Pam aktore.
 50. Thahen me bonifikime.
 51. Paguhet një për vonesa

VERTIKAL


1. Ato biometrike nuk kanë nevojë për viza
 2. Lindin në kokë
 3. Nota e diapazonit
 4. Janë të përpjeta.
 5. Një këngëtar lirтик.
 6. Mbyllin një dyqan.
 7. Mbarojnë fare
 8. Eshhtë grimcë me bërthamë.
 9. Eshhtë lloj papagalli.
 10. Paguhet për shërbim.
 12. Mund të jenë kasketa.
 13. Personazh i njohur i Woody Allen.
 18. Flet për Pegason dhe Belerofontit.
 20. Eshhtë anë kryesore gjaku.
 22. Eshhtë dukuna.
 23. Besim pa kufij
 25. Si stinore.
 28. Mund të ishin bukanierë.
 31. Mbyllin portat.
 33. Claude-Oscar piktor.
 35. Eshhtë shkronjë e rezistencës
 36. Lumë në Francë.
 39. Pak dendësi.
 42. Rastet pa set
 45. Fillojnë detyrën.
 47. Rastisin në krye.
 49. Inicialet e Magritte piktor.




Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

4					8				
		3	8			9			2
		7			1			4	
					3		9	5	
7									6
	5	2			4				
	6			7				1	
1			6			4	9		
			1						3

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	5	1	4	6	2	9	7	3
9	6	4	7	3	5	1	8	2
2	7	3	8	9	1	4	5	6
3	8	6	2	1	7	5	9	4
1	9	5	3	4	8	6	2	7
7	4	2	9	5	6	8	3	1
4	2	9	1	8	3	7	6	5
5	3	8	6	7	4	2	1	9
6	1	7	5	2	9	3	4	8

Argëtim filozofik

Kur një baba i jep djalit, qeshin të dy. Kur një djalë i jep babait, qajnë të dy.

Kritiku, sepse nuk është i aftë të krijojë asgjë, përpigjet të shkatërrojë atë që krijonin të tjerët.

"Rruga më e afërt mes dy njerëzve, është një buzëqeshje"

Lumturia është rezultat i gëzimit të brendshëm


Jepu të tjerëve atë që meritojnë, jo atë që kërkojnë.....

Thënie të mençura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



Ndërsa të tjerët blejnë sende të shtrenjta të kënaqësive të tyre, unë furnizoj, pa asnjë shpenzim, gëzimet e shpirtit, të cilat janë patundësisht më të pastra.

Nëse shikoni brenda jush, nuk do të mbeteni kurrë jashtë.

- Gjithë mudi i njeriut është për gojën dhe shpirtin
- i tij mbetet i uritur.
- Pasuria shpirtërore ka të mirën e vet, sepse
- nuk tatohet.
- Kur dikush më thotë: "Unë nuk do ta bëj kurrë këtë", thjeshtë buzëqesh dhe pres....

